

ZËRRANITË E TË REJAVE DHE TË RINJVE

Barazia Gjinore dhe
Kohezioni Social në
Ballkanin Perëndimor



YOUTH

Inclusion, Equality & Trust

ZËRAT E TË REJAVE DHE TË RINJVE

Barazia Gjinore dhe Kohezioni Social në Ballkanin Perëndimor

FALËNDERIM

Zhvillimi i studimit “Zërat e Të Rejave dhe Të Rinjve: Barazia Gjinore dhe Kohezioni Social në Ballkanin Perëndimor” ishte me të vërtetë një përpjekje me pjesëmarrje dhe u realizua me kontribute, njohuri dhe udhëzime të shumë partnerëve/partnereve dhe të rinjve/të rejave, ndaj të cilëve/cilave shprehim mirënjohjen tonë të përzemërt.

Studimi u realizua nga UN Women në kuadër të nismës rajonale të Kombeve të Bashkuara ‘Të Rejat dhe të Rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim’. Studimi është zbatuar nga UNDP, UNFPA, UNESCO dhe UN Women.

Falënderimi ynë i thellë shkon për hulumtuesit/et e rinj/reja që ishin përgjegjës/e për hartimin e raporteve vendore, të cilët/cilat punuan nën mbikëqyrjen e çmuar të Hulumtueses Udhëheqëse, Profesoreshës Zilka Spahić Šiljak, autore e raportit rajonal, dhe me mbështetjen e Hulumtueses së Lartë, Dr. Mary Drosopoulos. Ekipi hulumtues përbëhej nga Liri Kuçi, Dr. Natasha Vuçenović, Hana Bacaj, Sara Milenkovska dhe Dr Rodoljub Jovanović.

Po ashtu, duam të vlerësojmë kontributin e Lattanzio KIBS dhe BST Impact. Lattanzio KIBS, përfaqësuar nga Luca Cuzzocrea, Elisa Maria Soru, Alessandra Gatti dhe Riccardo Vino ofruan mbështetje thelbësore për menaxhimin e projektit, menaxhimin e proceseve të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, organizimin e ngjarjeve të shumta virtuale dhe me prani personale, duke ofruar dizajnin dhe identitetin vizual për këtë raport hulumtues rajonal. BST Impact, përfaqësuar nga Silvia Scozia dhe Giulia Biselli, e kanë mbështetur hulumtimin duke koordinuar dhe udhëhequr ekipin hulumtues përgjatë aktiviteteve të projektit, duke përfshirë këshillimin për hartimin e raportit, pyetjet e hulumtimit, strukturën, hartimin dhe redaktimin e dokumenteve të hulumtimit.

Duam të shprehim falënderimin tonë për kontributet e jashtëzakonshme dhe mbështetjen e palëkundur që kanë dhënë z. Michele Ribotta dhe znj. Danjela Celaj nga UN Women Shqipëri, si dhe z. Thomas Jackson nga UNDP Serbi. Falënderim i veçantë shkon edhe për të gjithë kolegët/koleget tanë/tona të nderuar/a në UN Women në rajonin që mbulon projekti, të cilët/cilat bujarisht kanë ndarë njohuritë dhe komentet e tyre të vlefshme gjatë fazës përgatitore të hulumtimit.

Po ashtu, falënderojmë të gjithë studentët/et e përkushtuar/a, profesionistët/profesionistet dhe aktorët/et e shoqërisë civile, të cilët/cilat kanë vepruar si bashkë-rishikues/bashkë-rishikuese të rinj/reja të drafteve të raporteve vendore duke dhënë një kontribut të vlefshëm për ekipin: Xhenson Cela, Paola Gosa, Nikola Kandiq, Sajra Kustura, Agon Rexhepi, Elvana Shala, Teodora Mileska, Elena Saveska, Veso Damjanoviq, dhe Ljubica Darkoviq.

Falënderim i veçantë shkon për anëtarët/anëtares e ekipit që kanë mbështetur angazhimin e të rinjve/të rejave nga i gjithë rajoni: Esmeralda Doku, Xheni Hatillari, Ivana Kulic, Jovana Marjanovic, Ajna Jusic, Jadranka Milicevic, Sara Vukicevic, Klevisa Kapo, e shumë të tjerë/të tjera që kanë dhënë mbështetje të vlefshme gjatë gjithë aktiviteteve të projektit.

Gjithashtu, falënderojmë për kontributin e tyre të gjithë të rinjtë/të rejat që morën pjesë në hulumtim dhe ndanë pikëpamjet dhe këndvështrimet e tyre në anketë, gjatë diskutimeve në grup dhe intervistave.

Në fund, dëshirojmë të falënderojmë Fondin e Kombeve të Bashkuara për Ndërtimin e Paqes për mbështetjen bujare. “Zërat e të Rejave dhe të Rinjve: Barazia Gjinore dhe Kohezioni Social në Ballkanin Perëndimor” u financua plotësisht nëpërmjet mbështetjes së tyre.

Youth 4 Inclusion, Equ



Deklaratë për mospranim përgjegjësie: Ky studim u mbështet nga UN Women, në kuadër të nismës së Kombeve të Bashkuara “Të Rejat dhe Të Rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim”, të financuar nga Fondi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Ndërtimin e Paqes dhe u zbatua nga Agjencitë dhe zyrat e OKB-së të udhëhequra nga Programi i OKB-së për Zhvillim (UNDP) në Serbi, në bashkëpunim me UNDP, UNFPA, UNESCO dhe UN Women. Përmbajtja e këtij publikimi, si dhe rezultatet e paraqitura në të, përfaqësojnë pikëpamjet e autorëve/eve për seksionet e tyre përkatëse, të cilët/cilat punuan nën mbikëqyrjen e Lattanzio KIBS, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Ndërtimin e Paqes dhe UN Women.

Autore/ë: Zilka Spahić Šiljak, Liri Kuçi, Nataša Vučenović, Hana Bacaj, Sara Milenkovska, Rodoljub Jovanović

Grafika dhe Faqosja: HL Branding

© 2023 UN Women. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
HYRJE	14
1. METODOLOGJIA	18
1.1 Qasja me pjesëmarrje	19
1.2 Qëllimi i studimit, temat kryesore dhe pyetjet	20
1.2.1 Shqyrtimi i literaturës dhe qasjet teorike	22
1.2.2 Konsultimet rajonale online	24
1.3 Kampioni i hulumtimit	27
1.3.1. Anketa sasiore dhe analiza e të dhënave	28
1.3.2. Hulumtimi cilësor	30
1.4. Etika	34
1.5. Kufizimet	36
2. SFIDAT E BARAZISË GJINORE DHE KOHEZIONIT SOCIAL NË RAJON	40
2.1 Perceptimet e të rinjve/të rejave për barazinë gjinore dhe kohezioni social	44
2.2 Faktorët që mbështesin barazinë gjinore dhe kohezionin social	48
2.3 Marrëdhëniet ndër-grupore dhe kohezioni social	54
2.4 Ndikimi i trashëgimive negative të së kaluarës	60
3. PENGESAT PËR BARAZINË GJINORE DHE KOHEZIONIN SOCIAL NGA PERSPEKTIVA E TË RINJVE/TË REJAVE	66
3.1. Rolet e ngurta gjinore dhe pritshmëritë gjinore të stereotipizuara	66
3.2. Dhuna me bazë gjinore	70
3.2.1 Ndikimi i mashkulloritetit të militarizuar në nivelin e dhunës ndaj grave	72
3.2.2 Ndikimi i pandemisë Covid-19 në shfaqjen ose ashpërsinë e rasteve të dhunës me bazë gjinore	76
3.2.3 Përvojat e dhunës dhe diskriminimit	77
3.3 Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes	80
3.4 Përhapja e fjalimeve polarizuese të identitetit	82
4. PERCEPTIMET E TË RINJVE/TË REJAVE PËR INSTITUCIONET PUBLIKE	88
4.1. Barazia në arsim dhe punësim	89
4.2. Promovimi i barazisë gjinore dhe kohezionit social	90
4.3. Përfaqësimi i grave në arenën politike	92

5. PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË PËR BARAZI GJINORE DHE KOHEZION SOCIAL: RISQET DHE MUNDËSITË	96
6. REKOMANDIMET NGA TË RINJTË/TË REJAT	100
PËRFUNDIMET	106
PUNIMET HULUMTUESE VENDORE	109
BIBLIOGRAFIA	110

LISTA E IMAZHEVE DHE FIGURAVE

<i>Imazhi 1. Qëllimet dhe metodologjia e hulumtimit</i>	18
<i>Imazhi 2. Kampioni në hulumtimin cilësor dhe sasior</i>	27
<i>Imazhi 3. Pasqyrë demografike e të anketuarve/të anketuarave në anketë</i>	28
<i>Imazhi 4. Pasqyra demografike e pjesëmarrësve/pjesëmarrëseve në konsultime</i>	33
<i>Imazhi 5. Grup fjalësh për kohezionin social</i>	44
<i>Imazhi 6. Grup fjalësh për barazinë gjinore</i>	46
<i>Figura 1. Faktorët që ndihmojnë shoqëritë më të forta dhe më të drejta</i>	48
<i>Figura 2. Besimi ndërgrupor dhe sjellja e qasjes (I)</i>	54
<i>Figura 3. Besimi ndër-grupor dhe sjellja e qasjes (II)</i>	57
<i>Figura 4. Besimi i komunitetit dhe sjellja e qasjes (III)</i>	59
<i>Figura 5. Perceptimet e të rinjve/të rejave për pritshmëritë e ndryshme ndaj burrave dhe grave</i>	66
<i>Figura 6. Perceptimet e të rinjve/të rejave për dhunën në familje ose familjare</i>	71
<i>Figura 7. Përvojat e diskriminimit në komunitetet e marginalizuara</i>	80
<i>Figura 8. Perceptimet e të rinjve/të rejave për lëvizjet kundër barazisë gjinore</i>	82
<i>Figura 9. Perceptimet e të rinjve/të rejave për faktorët që do të ndihmonin në arritjen e barazisë gjinore</i>	90

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nisma e Kombeve të Bashkuara 'Të Rejat dhe Të Rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim' ¹ synon të **fuqizojë të rinjtë/ të rejat që të përfshihen në narrativa konstruktive, të fuqizojnë dialogun ndërkulturor, përfshirjen dhe barazinë gjinore dhe të krijojë mirëkuptim dhe besim të ndërsjellë** në rajon. Studimi rajonal që u zbatua nga UN Women dhe u bashkë-hartua, realizua dhe zhvillua nga pesë hulumtues/e të rinj/të reja nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina (BiH), Kosova², Maqedonia e Veriut dhe Serbia synon të hulumtojë lidhjet ndërmjet zhvillimit të të rinjve/të rejave dhe sfidave të barazisë gjinore dhe kohezionit social në rajon³. Si **studimi i parë plotësisht i projektuar dhe udhëhequr nga të rinjtë/ të rejat në rajon**, ai u ka dhënë hulumtuesve/eve të drejtat e pronësisë për këtë studim dhe ka krijuar hapësirë për kontributin e tyre duke u mbështetur në përvojat e tyre në këtë fushë.

Në këtë studim me pjesëmarrje është aplikuar **metoda e përzier e hulumtimit**, duke kombinuar shqyrtimin e dokumentacionit, mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore. Hulumtimi përfshin **më shumë se 1200 të rinj/ të reja** nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, të moshës 18-30 vjeç, të cilët/cilat morën pjesë në dy konsultime rajonale online, një konsultim rajonal me prani fizike, një anketë online, pesë konsultime vendore dhe 15 intervista të thelluara individuale.

Gjetjet kryesore të studimit, si në vijim, dolën nga analiza rajonale e të dhënave sasiore dhe cilësore të mbledhura.

¹ Ky projekt studimor u financua nga Fondi i OKB-së për Ndërtimin e Paqes dhe u zbatua nga UNDP, UNFPA, UNESCO, UN Women dhe ministrinë përkatëse, këshillat bashkiak dhe rinor, partitë politike të të rinjve, mediat, institucionet akademike dhe kulturore, si dhe organizatat e shoqërisë civile.

² Të gjitha referencat për sa i përket Kosovës do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (1999)

³ Dallimet e vërejtura ndërmjet burrave dhe grave nuk janë konsideruar të rëndësishme për objektivin e këtij punimi rajonal, i cili ishte ofrimi i një përfaqësimi gjithëpërfshirës të perceptimeve të të rinjve/të rejave për çështjet që ishin objekt i studimit.

- Kohezioni social dhe barazia gjinore ndërliidhen me vlerat thelbësore të diskursit më të gjerë **që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, demokracinë, drejtësinë sociale dhe solidaritetin.**
- Të rinjtë/Të rejtat pjesëmarrës/e nuk vërejnë ndonjë nivel të lartë të kohezionit social apo të barazisë gjinore në komunitetet e tyre.
- **Trashëgimitë negative** të së kaluarës janë identifikuar nga të rinjtë/të rejtat pjesëmarrës/e si një nga faktorët kryesorë që pengon, barazinë gjinore specifikisht dhe kohezionin social përgjithësisht. Në veçanti, trashëgimitë e tilla negative marrin format e **izolimit, frikës, mosbesimit ndërmjet gjeneratave, si dhe të mashkulloritit hegjemonist dhe të militarizuar** të lidhur me prapambetjet e mentalitetit '*nekundër tyre*'. Ndër të tjera, ato pasqyrohen në normat kulturore dhe patriarkale që kontribuojnë në rezistencën e shoqërisë ndaj përmirësimit dhe emancipimit. Pasojat e kësaj janë mundësitë e kufizuara dhe progresi i shtypur drejt barazisë gjinore.
- Analiza e marrëdhënieve ndërgrupore tregon disa rezultate inkurajuese, **me një shkallë të lartë të raporteve miqësore ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe/ose fetare.** Megjithatë, rezultatet, tregojnë edhe një **rritje të distancës sociale siç është rasti i intimitetit të marrëdhënieve** në fjalë.
- Përveç qasjes së barabartë në arsim dhe mundësi të barabarta për punë, **barazia gjinore konsiderohet faktor i rëndësishëm në ndërtimin e shoqërive më të forta dhe më të drejta.** Mirëpo, ky studim nxjerr në pah edhe një dozë skepticizmi për sa i përket nismave për barazi gjinore, pasi në disa raste, ato shihen si kundër-produktive, që do të thotë se ato kontribuojnë në polarizimin e mëtejshëm.
- Normat pozitive ligjore garantojnë zyrtarisht barazinë, por pjesëmarrësit/et shprehin se **mungojnë mekanizmat për zbatimin e vërtetë të legjislacionit ekzistues** për të siguruar barazinë gjinore.
- **Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes** janë dukuri mjaft të shpeshta që janë përjetuar drejtpërdrejtë, dëshmuar, ose edhe përjetuar edhe dëshmuar nga shumë të anketuar/të anketuara në hulumtimin sasior. Raca dhe/ose përkatësia etnike, statusi social, gjinia dhe seksualiteti ishin baza më e zakonshme për gjuhën e urrejtjes dhe/ose diskriminimin që kishin hasur të anketuarit/të anketuarat. Analiza sasimore tregoi se gratë dhe grupet minoritare kanë më shumë gjasa të përballen me diskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes në të gjitha kategoritë e lartpërmendura.
- Pjesëmarrësit/et treguan **vetëdijesim lidhur me dhunën me bazë gjinore** si një çështje që ndikon negativisht në kohezionin social dhe në mirëqenien

e të rinjve/të rejave në komunitetet e tyre. Të rinjtë/të rejtat theksuan **rolin e mashkulloritit të militarizuar dhe toksik në vazhdimësinë e dhunës me bazë gjinore**, normalizimin e sjelljeve të caktuara dhe mungesën e vetëdijesimit në lidhje me çfarë përbën dhuna me bazë gjinore. Gjithashtu është theksuar roli i mediave dhe mediave sociale në mbajtjen e narrativave që normalizojnë dhe e minimizojnë problemin e dhunës në familje dhe pasojat e saj shkatërruese.

- **Sistemet ekzistuese të mbështetjes për viktimat janë të pamjaftueshme**, siç janë edhe reagimet institucionale. Si pasojë raportimi i rasteve të dhunës me bazë gjinore duket i padobishëm. Po ashtu, vihet re **stigmatizimi dhe turpi që ndërliiden me të folurit për dhunën me bazë gjinore** siç theksuan pjesëmarrësit/et, të cilët/cilat edhe vetë ngurronin të ndanin përvojat e tyre konkrete të dhunës me bazë gjinore.
- **Ndikimi i pandemisë Covid-19 në dhunën me bazë gjinore u konsiderua kryesisht si një faktor ndërmjetësi**: perceptimi i të rinjve/të rejave ishte se përkeqësimi i çështjeve siç është izolimi, përhapja e keqinformacioneve, problemet e shëndetit mendor, dobësimi i funksionimit të sistemeve përkatëse të mbështetjes institucionale sollën efektet negative të Covid-19 në kohezionin social përgjithësisht, dhe në rritjen përkatëse të dhunës me bazë gjinore në mënyrë të veçantë.

- Pjesëmarrësit/et e rinj/reja treguan një **ndërgjegjësim të thellë të normave të ngurta patriarkale gjinore të rrënjësura në strukturën e shoqërisë**, si dhe kufijtë dhe pengesat që këto norma i shkaktojnë gjeneratës së tyre. Gjeneratat e vjetra shihen si ruajtës dhe transmetues të këtyre normave, të cilat të rinjtë/të rejtat i identifikojnë si pjesë e edukimit familjar dhe shoqërizimit parësor.
- **Arsimi luan rol të rëndësishëm në vazhdimin dhe përforcimin e normave të ngurta gjinore**, si dhe një sistem ku dhuna me bazë gjinore mund të bëhet normale. Kjo ndodh, për shembull, për shkak të faktit se arsimtarët/et kultivojnë normat tradicionale gjinore në sjelljen e nxënësve/eve; si dhe për shkak të zgjedhjeve të ardhshme për arsimim/karrierë me stereotipa gjinorë, mungesës së kurrikulave që do të adresonin çështjet si barazia gjinore, edukimi seksual dhe pëlqimi. Përveç kësaj, shkollat mund të jenë vende për shfaqjen e hershme të sjelljeve (si për shembull prekja e vajzave nga djemtë), por nuk ka sisteme të vendosura për të adresuar çështjet e tilla.
- **Mungon edukimi i duhur seksual, si dhe edukimi i fëmijëve dhe të rinjve/të rejave** për tema si gjinia dhe shëndeti mendor, gjë që kontribuon në akumulimin e efekteve negative të normave të ngurta patriarkale dhe në normalizimin e sjelljeve të dëmshme.

- Gjithashtu, të rinjtë/të rejat, shfaqën **vetëdijesim lidhur me përhapjen e gjuhës polarizuese për identitetin në media sociale dhe media të tjera.** Shumica e tyre theksuan se lëvizjet, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, që promovuan mesazhe që përmbajnë retorikë etno-nacionaliste/populiste ose diskriminim ndaj pakicave, kanë mbartur edhe promovimin e pabarazisë gjinore dhe diskriminimit ndaj grave dhe individëve LGBTQIA+.
- Të rinjtë/Të rejat shfaqin një **shkallë të ulët besimi te institucionet publike, politikanët/et dhe institucionet fetare.**
- Të rinjtë/Të rejat e perceptojnë **qasjen në arsim dhe mundësinë e punësimit të grave dhe vajzave, si dhe grupeve tjera minoritare, siç janë emigrantët, personat me aftësi të kufizuara dhe romët si pabarazi ekstreme.**
- **Përfshirja e shtuar e grave në politikë dhe pozita kyç vendimmarrëse** mund të nxisë përparimin dhe të sjellë më shumë vëmendje ndaj perspektivave dhe nevojave të grupeve të marginalizuara. Megjithatë, masat që promovojnë pjesëmarrjen e grave në politikë duhet të synojnë ndryshim të vërtetë, në vend të gjesteve simbolike apo plotësimit të kuotave, të cilat nuk ofrojnë një platformë për zërat që flasin dhe luftojnë për të drejtat e grave.
- **U identifikua se teknologjia ka potencial për të ndikuar pozitivisht**

dhe negativisht në kohezionin social dhe barazinë gjinore.

Nga njëra anë, përvoja e të rinjve/të rejave me mediat sociale thekson potencialin e saj për të përhapur keqinformacione, bullizmin kibernetik, promovimin e narrativave të dëmshme, ngacmimet e parregulluara/të rregulluara dobët dhe pa pasoja, si dhe gjuhën e urrejtjes. Nga ana tjetër, ka raste kur mediat sociale kanë pasur ndikim pozitiv në luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe në mbështetje të viktimave, dhe është theksuar potenciali i mediave sociale si një vend ku të rinjtë/të rejat mund të organizojnë lëvizje bazë, të shkëmbejnë përvojat dhe të ngrenë zërin në mbështetje të grupeve të marginalizuara.

- Rekomandohet **fuqizimi i të rinjve/të rejave** për t'u bërë udhëheqës të komunitetit të cilët/cilat me kalimin e kohës do të jenë në gjendje të nxisin ndryshimet sistematike, si dhe të përfshihen më shumë me media dhe në institucione publike.
- **Nxitja e dialogut, diskutimi dhe reflektimi kritik** për çështjet kyç që kanë të bëjnë me barazinë dhe kohezionin social u theksuan si një hapi parë dhe i rëndësishëm. Pjesëmarrësit/et pohuan se diskutimet që ishin pjesë e kësaj nisme ofruan një mundësi të tillë dhe theksuan vlerën e krijimit të hapësirave për diskutim dhe zgjidhje të problemeve.

Të dhënat e mbledhura nga hulumtimi kanë ofruar të dhëna të vlefshëm se si të rinjtë/të rejat nga i gjithë rajoni do të donin të shihnin trajtimin e sfidave të barazisë gjinore dhe të kohezionit social. Qoftë nëpërmjet zbatimit të politikave publike, fushatave të të rinjve/të rejave dhe planeve të veprimit, veprimeve të shoqërisë civile, apo nismave individuale të aktivistëve/aktivisteve të rinj/të reja nëpërmjet përdorimit të mjeteve digjitale, pjesëmarrësit/et e rinj/reja kanë arritur me entuziazëm që të dëgjohet zëri i tyre.

Një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe e barabartë mund të krijohet vetëm nëpërmjet **hulumtimit më të thellë të ndikimit të narrativave të së kaluarës në çështjet bashkëkohore, duke u mundësuar të rinjve/të rejave të mësojnë nga historia dhe të ndërtojnë një të ardhme të bazuar në drejtësi dhe solidaritet**. Edhe pse plotësisht të vetëdijshëm për sfidat me të cilat përballen, të rinjtë/të rejat demonstrojnë entuziazëm të madh për t'i trajtuar ato, si dhe vullnet të fortë për të qenë shtytës të ndryshimit në komunitetet e tyre.



“Askush nuk më ka kërkuar të them ndonjë gjë për këtë!” *Pjesëmarrës/Pjesëmarrëse në konsultimet vendore, Serbi*

Ky është pohimi i një të reje gjatë konsultimeve vendore, e cila komentoi se të rinjve/të rejave rrallë u kërkohet të thonë diçka për ndërtimin e paqes, kohezionin social dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën publike dhe politike. Të rinjtë/Të rejtat janë kryesisht të përjashtuar nga proceset e vendimmarrjes, planifikimit, politikëbërjes në rajon, dhe ata/ato rrallë konsultohen dhe përfshihen në procesin e negociatave për çështjet e paqes së qëndrueshme dhe kohezionit social. Edhe pse kanë diçka kuptimplote për të thënë, zërat e tyre shpesh anashkalohen.

Në kuadër të kësaj, nisma e Kombeve të Bashkuara ‘Të Rejat dhe të Rinjtë për Përfshirje, Barazi dhe Besim’⁴ synon fuqizimin e tyre për përfshirje në narrativa konstruktive, fuqizimin e dialogut ndër-kulturor, përfshirjen dhe barazinë gjinore dhe krijimin e mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë në rajon. Studimi rajonal që u zbatua nga UN Women dhe bashkë-hartua, realizua dhe zhvillua nga pesë hulumtues/e të rinj/reja nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina (BiH), Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia synon të hulumtojë lidhjet ndërmjet zhvillimit të të rinjve/të rejave dhe sfidave të barazisë gjinore dhe kohezionit social në rajon. Ky është studimi i parë dhe i vetëm që është plotësisht i projektuar dhe i udhëhequr nga të rinjtë/të rejtat në rajon.

Në krye të studimit ishin pesë hulumtues/e të rinj/reja, secili/a përgjegjës/e për vendin përkatës. Këta/Këto janë: Liri Kuçi (Shqipëri); Dr. Natasha Vuçenović (Bosnjë dhe Hercegovinë); Hana Bacaj (Kosovë); Sara Milenkovska (Maqedonia e Veriut) dhe Dr. Rodoljub Jovanović (Serbi); të cilët/cilat janë autorë/e të shtojcave përkatëse, duke përshkruar në hollësi çdo fazë të hulumtimit, vrotimet dhe konkluzionet e tyre. Ata/Ato kanë punuar nën mbikëqyrjen e hulumtueses kryesore, Profesor Zilka Spahić Šiljak dhe me mbështetjen e hulumtueses së lartë, Dr. Mary Drosopoulos.

Debatet për kohezionin social kanë një zhvillim dhe kuptim specifik në çdo kontekst socio-kulturor dhe politik. Edhe pse kohezioni social mund të ekzistojë në shoqëritë patriarkale me një dinamikë hierarkike të rolit gjinor, Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë zhvilluar një qasje gjithëpërfshirëse duke vënë theksin te barazia, mundësitë e barabarta, diversiteti dhe mirëqenia për të gjithë qytetarët/et. (Astealarra, 2007) Ato kanë kuptuar se të drejtat sociale, politike dhe ekonomike nuk mund të ushtrohen plotësisht nëse gratë dhe burrat, si dhe grupet e cenueshme të qytetarëve/eve nuk kanë të drejta dhe mundësi të njëjta. Prandaj, barazia gjinore u bë një nga komponentët thelbësorë në diskutimet dhe politikat për kohezionin social. Globalizimi dhe zhvillimi post-modern sollën barazinë gjinore në qendër të vëmendjes

⁴ Ky projekt hulumtues u financua nga Fondi i OKB-së për Ndërtimin e Paqes dhe u zbatua nga UNDP, UNFPA, UNESCO, UN Women dhe ministritë përkatëse, këshillat bashkiak dhe rinor, partitë politike të rinjve, mediat, institucionet akademike dhe kulturore, si dhe organizatat e shoqërisë civile.

institucionale, si një qëllim ndër-sektorial që duhet marrë parasysh gjatë planifikimit, hartimit, zbatimit dhe matjes së politikave, strategjive dhe zhvillimit ekonomik të shtetit; megjithatë, në shumë vende të botës, fragmentimi, ndarjet etnike, si dhe ato politike dhe ekonomike kanë thelluar polarizimin.

Disa autorë (Lopez, 2007; Blagojeviq, 2002) kanë diskutuar për “paradoksin gjinor të kohezionit social”, duke iu referuar fenomenit social që karakterizohet nga fakti se gratë që investojnë kaq shumë në kujdesin dhe ndërtimin e marrëdhënieve dhe besimit në familje dhe shoqëri, në të njëjtën kohë, janë të përjashtuara dhe nuk kanë mundësi të barabarta me burrat. Ato që angazhohen më së shumti në punë të papaguara dhe të dobishme për themelet e kohezionit social nuk gëzojnë të gjitha përfitimet e mirëqenies sociale.

Në rajon, kohezioni social është hulumtuar më së shumti në kuadër të të drejtave sociale dhe politike dhe distancës sociale (Majstoroviç & Turjaçanin, 2013; Radovanoviç & Stojanoviç Gajic, 2013; Aviroviç-Bundalevska, 2019) ndërsa për sa i përket studimeve për barazinë gjinore (Danaj et.al., 2019, Demukaj et.al., 2019; Kuçi 2021; Baboviç, & Petroviç, 2021, Spahić Šiljak et al. 2022) janë fokusuar në faktorët që e pengojnë atë. Megjithatë, rrallë janë bërë studime për ndërlidhjen mes barazisë gjinore dhe kohezionit social. Për këtë arsye, ky hulumtim përfaqëson iniciativën e parë të udhëhequr nga të rinjtë/të rejat që mat këtë ndërlidhje.

Pesë hulumtues/e të rinj/reja nga vendet që mbulon projekti janë përfshirë gjatë fazës së projektimit të hulumtimit, për zhvillimin e metodologjisë, si dhe hartimin e pyetjeve për instrumentet e mbledhjes së të dhënave (anketa, pyetjet e thëlluara të intervistës dhe pyetjet për konsultime në grup). Dhënia e të drejtave të pronësisë për hulumtuesit/et ka krijuar hapësirë për kontributin e tyre bazuar në përvojat e tyre në këtë fushë.

Një element inovativ i këtij hulumtimi mbështetet, në mënyrë specifike, në natyrën e tij pjesëmarrëse. Hulumtimi ka një qasje të orientuar në praktikë, duke kombinuar njohuritë akademike me njohuritë dhe perspektivat eksperimentale të pjesëmarrësve/eve. Hulumtuesit/et janë të rinj/të reja nga rajoni të cilët/cilat përveçse po realizojnë studimin, janë edhe pjesëmarrës/e në të, duke ofruar këndvështrimet e tyre për pyetjet kryesore të studimit. Hulumtuesit/et kanë reflektuar në mënyrë kritike mbi paragjykimet dhe supozimet e tyre për të kuptuar ndikimin e mundshëm të pozicionimit të tyre në procesin dhe rezultatet e hulumtimit.



METODOLOGJIA

1



1. METODOLOGJIA

Ky hulumtim rajonal i udhëhequr nga të rinjtë/të rejat, përveç se kontribuon në diskutimet akademike për kohezionin social dhe barazinë gjinore, synon që me rezultatet e tij të mbështesë ndërtimin e narrativave të bazuara në fakte dhe të informojë politikat dhe përpjekjet advokuese në Ballkanin Perëndimor.

Ky kapitull prezanton qëllimin e hulumtimit, temat kryesore, përkufizimet, metodat, kampionin, çështjet etike dhe kufizimet e studimit. Pjesa inovative dhe vlera shtesë e këtij studimi është qasja me pjesëmarrje me një metodë të përzier hulumtimi, duke kombinuar shqyrtimin e

dokumentacionit, mbledhjen sasiore dhe cilësore të të dhënave.

Metoda e përzier e hulumtimit (Berg, 2009, Creswell 2009) është kërkuese dhe komplekse me një sfond filozofik dhe teorik, mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe përfshin ndërthurjen e të dhënave dhe verifikimin e ndërsjellë, i cili ndihmon në rafinimin e tërë procesit të hulumtimit dhe validimit të rezultateve.

Kjo metodë, po ashtu, u mundëson hulumtuesve/eve të kenë të kuptuar më të plotë të gjetjeve kryesore dhe zbatimin e tyre në praktikë.

Qëllimet, objektivi dhe metodologjia e hulumtimit



Imazhi 1. Qëllimet dhe metodologjia e hulumtimit

1.1 Qasja me pjesëmarrje

Hulumtimi me pjesëmarrje përfshin bashkëpunimin në hartimin dhe zhvillimin e studimit ndërmjet hulumtuesve/eve dhe pjesëtarëve/eve të popullatës së synuar të prekur nga çështjet që hulumtohen, si dhe të synuar nga, ose të përfshirë në realizimin e planeve të mundshme të veprimit të projektuara në bazë të konkluzioneve që rrjedhin nga hulumtimi përkatës. Theksi vihet në qasjen “nga poshtë-lart”, duke marrë parasysh pikëpamjet, prioritetet dhe nevojat vendore (Jagosh et al., 2012; Waughn et.al., 2020).

Hulumtimi me pjesëmarrje mund të formësohet nëpërmjet një vargu qasjesh metodologjik- - fokusi është në hartimin e një kornize të përshtatshëm për qëllimet dhe kontekstin e një hetimi që është fleksibël dhe zhvillon çështjet dhe qasjet kyç nëpërmjet një procesi bashkë-ndërtimi me pjesëmarrësit/et. Kjo qasje metodologjike përfshin fuqizimin, bashkëpunimin, refleksitetin dhe transformimin (Pringle et.al., 2017) që rezonon me metodën e hulumtimit feminist të fokusuar në një qasje bashkëpunuese me qëllim të trajtimit të *statukuosë* dhe sjelljes së ndryshimeve për gratë dhe të paprivilegjuarit/at (Westmarland dhe Bows, 2019; Van Ingen, 2020; Husanović, 2022). Një nga tiparet kryesore të qasjes me pjesëmarrje të përdorur në hulumtime është shtrirja e prodhimit të njohurive nga qendra në periferi. Atyre që janë të përjashtuar nga qendra e privilegjuar e prodhimit të njohurive u jepet hapësirë për të identifikuar çështjet që i prekin, dhe për të pasur mundësi të shpjegojnë se si puna hulumtuese mund të jetë vepruese dhe transformuese. Ky hulumtim karakterizohet nga roli i dyfishtë i hulumtuesve/eve: ata/ato janë pjesëmarrës/e, si përfaqësues/e të grupeve të synuara, që jetojnë dhe përfshihen në komunitetet e tyre vendore, të prekur/a nga çështjet që hulumtohen, por gjithashtu shkruajnë dhe realizojnë këtë punë hulumtuese. Kështu, hulumtuesit/et e rinj/reja shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet përvojës akademike dhe asaj jetësore. Një përfitim tjetër i këtij roli të dyfishtë në realizimin e hulumtimit është aftësia e tyre për të komunikuar në mënyrë efektive me pjesëmarrësit/et e tjerë/tjera gjatë konsultimeve dhe diskutimeve në grup, për të siguruar angazhim dhe hapje, si dhe për të interpretuar dhe ndërvepruar me atë që është shprehur nëpërmjet lentës së nuancuar të vetëdijshëm për specifikat kontekstuale. Kjo mundëson diskutimin ku pjesëmarrësit/et mund të ndihen rehat kur shprehen brenda “kornizës së tyre kontekstuale”, duke e ngushtuar më tej hendekun ndërmjet hulumtimit dhe përvojës së përjetuar. Në fakt, hulumtuesit/et kanë reflektuar se aftësia e tyre për ta kuptuar kontekstin e pjesëmarrësve/eve dhe specifikat e mënyrës se si ata/ato komunikojnë, siç është përdorimi i gjuhës ose shakave të brendshme, i kanë ndihmuar ata ta kuptojnë dhe drejtojnë diskutimin. Përveç kësaj, është vërejtur se të rinjtë/të rejat e përfshirë/a në diskutim, përgjithësisht ishin proaktivë dhe të motivuar, demonstruan se ishin të informuar/a mirë dhe reflektonin në mënyrë kritike për çështjet që diskutoheshin, gjë që tregon **rëndësinë e krijimit të hapësirave komode dhe të qasshme për të rinjtë/të rejat** që të **shkëmbejnë mendimet, njohuritë dhe përvojat e tyre**.

Përveç rolit të dyfishtë të hulumtuesve/eve, natyra pjesëmarrëse e hulumtimit reflektohet edhe në procesin e hartimit dhe zbatimit, siç është shpjeguar në seksionin 1.2.2. më poshtë.

1.2 Qëllimi i studimit, temat kryesore dhe pyetjet

Hulumtimi trajton ekskluzivisht⁵ pikëpamjet e të rinjve/të rejave lidhur me sfidat e barazisë gjinore dhe kohezionit social në rajon. Ai synon të fuqizojë të rinjtë/të rejtat në të gjithë rajonin duke i vlerësuar dhe përfshirë pikëpamjet, njohuritë dhe përvojat e tyre për të nxjerrë rekomandime të zbatueshme dhe të qëndrueshme, të afta për të frymëzuar masa konkrete për trajtimin kuptimplotë të sfidave të identifikuar në kuadër të barazisë gjinore dhe kohezionit social dhe për të nxitur ndryshime pozitive sociale në rajon.

Pjesëmarrësve/eve në hulumtim u janë dhënë përkufizimet përkatëse sa herë që ishte e nevojshme gjatë konsultimeve vendore në mënyrë që të lehtësohet të kuptuarit e fushëveprimit dhe fokusi i diskutimit. Më poshtë gjeni përkufizimet në shqip të koncepteve kyç të hulumtimit që janë përdorur si pika referimi. Në përputhje me shqyrtimet e hershme metodologjike, disa koncepte mund të jenë shpjeguar verbalisht në një mënyrë të thjeshtuar për të lehtësuar të kuptuarit nga pjesëmarrësit/et.

Kohezioni social: shkalla e besimit në institucione dhe në shoqëri – që është (1) shkalla e besimit në aftësinë e institucioneve për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë dhe procese efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, dhe (2) ndjenja e besimit brenda popullatës nga identitete të ndryshme dhe vullneti për të marrë pjesë në mënyrë kolektive drejt një vizioni të përbashkët të paqes së qëndrueshme dhe qëllimeve të përbashkëta për zhvillim.⁶

Barazia gjinore: të drejta, përgjegjësi dhe mundësi të barabarta për gratë dhe burrat dhe vajzat dhe djemtë. Barazia nuk do të thotë që gratë dhe burrat do të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e grave dhe të burrave nuk do të varen nga fakti nëse ato lindin mashkull apo femër. Barazia gjinore nënkupton që të merren parasysh interesat, nevojat dhe prioritetet e grave dhe burrave, duke njohur diversitetin e grupeve të ndryshme të grave dhe burrave.⁷

⁵ Përkufizimi i OKB-së: "RINIA kuptohet më së miri si një periudhë në të cilën bëhet kalimi nga të qenët të varur në fëmijëri të të qenët të pavarur në moshë madhore. Prandaj, si kategori, rinia është më e luhatshme se grupmoshat e tjera të qëndrueshme". Burimi: <https://www.un.org/esa/socdev/documents/youth/fact-sheets/youth-definition.pdf>

⁶ OECD (2012), "Treguesit e kohezionit social", në "Shoqëria në një Vështrim": Azi/Paqësor 2011, Botim i OECD. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264106154-11-en>.

⁷ UN Women, Zyra e Këshilltarit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për Çështjet Gjinore dhe Avancimin e Grave (OSAGI), Konceptet dhe Përkufizimet, shih <https://www.un.org/womenwatch/osagi/conceptsadefinitions.htm>

Ndërtimi i paqes: një proces kompleks dhe afatgjatë i krijimit të kushteve të nevojshme për paqe të qëndrueshme. Kjo përfshin një sërë masash që synojnë të reduktojnë rrezikun e futjes ose rifutjes në konflikt duke fuqizuar kapacitetet vendore në të gjitha nivelet për menaxhimin dhe transformimin e konfliktit drejt marrëdhënie më të qëndrueshme, paqësore, duke përfshirë me kujdes dhe prioritet një numër aktivitete të njëpasnjëshme dhe relativisht të ngushta për ta parandaluar shpërthimin, vazhdimin, përshkallëzimin dhe përsëritjen e konfliktit, si dhe për të promovuar qëndrueshmërinë e jetës dhe rindërtimin e komuniteteve vendore.⁸

Mashkulloriteti toksik: pritshmëritë tradicionale të shoqërisë për mashkulloritetin që mund të jenë të dëmshme për burrat, gratë dhe shoqërinë në tërësi. Këto pritshmëri mund të përfshijnë sjellje si ndrydhje emocionale, agresiviteti dhe dominimi, si dhe mospërfillja e mirëqenies emocionale dhe fizike. Mashkulloriteti toksik mund të shfaqet po ashtu si kulturë e seksizmit, homofobisë dhe dhunës ndaj grave, individëve LGBTQIA+ dhe grupeve të marginalizuara. Është me rëndësi të theksohet se mashkulloriteti toksik nuk i referohet të gjithë meshkujve apo mashkulloritetit në tërësi, por më tepër normave të dëmshme kulturore dhe sjelljeve që ndërlidhen me mashkulloritetin tradicional.⁹

Mashkulloriteti i militarizuar: model kulturor dhe model i sjelljes në të cilin përfaqësimi i sjelljes së përshtatshme për gjininë mashkullore shoqërohet me modele “ushtarake” të sjelljes.

Mizogjinia: urrejtja, përbuzja ose paragjykimi ndaj grave ose vajzave. Është një term që përshkruan një sërë qëndrimesh dhe sjelljesh negative ndaj grave, siç është seksizmi, diskriminimi, objektivizimi dhe dhuna. Mizogjinia mund të manifestohet në mënyra të ndryshme, përfshirë abuzimin verbal, dhunën fizike, ngacmimin seksual dhe diskriminimin me bazë gjinore.¹¹

⁸ Shih Zyrën për Mbështetjen e Ndërtimit të Paqes, “Ndërtimi i Paqes i OKB: Një Orientim”, 2010, f.5., në dispozicion në: https://www.un.org/peacebuilding/sites/www.un.org/peacebuilding/files/documents/peacebuilding_orientation.pdf

⁹ Studimi “The Man Box”. 2017. <https://www.equimundo.org/wp-content/uploads/2017/03/TheManBox-Full-EN-Final-29.03.2017-POSTPRINT.v3-web.pdf>

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

1.2.1 Shqyrtimi i literaturës dhe qasjet teorike

Faza e parë e studimit është shqyrtimi i thelluar i literaturës që u realizua nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit, që rezultoi me identifikimin e burimeve kryesore parësore dhe dytësore për të mbështetur hartimin e pyetjeve të hulumtimit, si dhe analizën e të dhënave. Nëpërmjet shqyrtimit të literaturës synohej hulumtimi i asaj që tashmë është bërë në rajon lidhur me kohezionin social, barazinë gjinore, të rinjtë/të rejat dhe ndërtimin e paqes, por edhe ofrimi i një arsytimi filozofik për hulumtimin e kryer nëpërmjet metodës së përzier. Ai përfshinte shqyrtimin e materialit përkatës ekzistues për studimin përkatës, si dhe studimin origjinal për përcaktimin e fakteve lidhur me dimensionet e barazisë gjinore të sfidave të kohezionit social në rajon. Në veçanti, aktiviteti përfshinte një analizë cilësore gjithëpërfshirëse të literaturës së disponueshme dhe të burimeve parësore dhe dytësore të informatave bazuar në identifikimin dhe analizën e informatave që janë në dispozicion të publikut (analiza e të dhënave lidhur me të dhënat e hapura, faqet e internetit, materialet online, etj.), nga të cilat ekipi i ka nxjerrë njohuritë përkatëse për të mbështetur zhvillimin e këtij punimi. Shqyrtimi i literaturës ishte edhe baza mbi të cilin fillimisht janë identifikuar temat e hulumtimit dhe ku është orientuar konsultimi fillestar rajonal duke mbledhur komentet e palëve të interesit, të cilat më pastaj janë përfshirë në çështjet kyçe të hulumtimit, siç është përshkruar hollësisht në seksionin 1.2.2 më poshtë.

Ekipi hulumtues ka mbledhur artikuj akademikë, hulumtime, raporte të organizatave ndërkombëtare (p.sh. OSBE, UNDP, UN Women, UNFPA), raporte të organizatave vendore të shoqërisë civile në secilin prej vendeve, si dhe politikat institucionale mbi rolin e rinisë.

Literatura ekzistuese në rajon e portretizon rininë si agjent të rëndësishëm të paqes dhe kohezionit social (Radoman 2020; Avirovic-Bundalevska 2019; Kelmendi 2023) dhe si zë të margjinalizuar që gjithashtu është “ndotur” me etno-nacionalizëm, mashkulloritete toksik dhe mos-tolerancë. Një nga arsytet është se shumica e të rinjve/të rejave në rajon kanë qenë të socializuar në komunitete etnikisht të ndara, dhe nuk i shohin identitetet e ndryshme etnike dhe fetare si një trashëgimi e vlefshme multi-kulturore, por si kategori reciprokisht përjashtuese në një luftë të vazhdueshme për të mbizotëruar mbi njëri-tjetrin (Majstorović dhe Turjačanin 2013; Mulalić & Karić 2017; Prato et.al. 2018; Turjačanin et al., 2020). Meqenëse barazia gjinore tashmë është identifikuar si një komponent kritik i kohezionit social, literatura zbulon se stereotipat gjinorë, seksizmi dhe mizogjinia e brendësuar ende i formëson regjimet gjinore në pesë vendet e hulumtuara (Demukaj et. Al. 2019; Danaj 2020; Drosopoulos 2020; Babovic, & Petrovic, 2021; Spahiq

Šiljak et.al. 2022; Vučenović 2022). Kjo do të thotë se institucionet duhet të miratojnë politika dhe strategji të ndjeshme gjinore për të përfshirë më shumë gra dhe të rinj/të reja në proceset e paqes, siç është pranuar tashmë në rajon (UNDP 2020; OSBE 2020; Ćeriman dhe Spahić Šiljak 2020; Kuci 2023). Përveç kësaj, literatura ka sugjeruar se pandemia Covid-19 ka thelluar pabarazitë gjinore dhe ka shtuar dhunën me bazë gjinore, e që paraqet një sfidë shtesë në luftimin e praktikave diskriminuese ndaj grave dhe grupeve të marginalizuara, veçanërisht pakicave të përkatësisë seksuale, personave me aftësi të kufizuara si dhe pakicave etnike. (Kuci dhe Xhafa 2020; Radoman 2020).

Dy qasje teorike janë të rëndësishme për këtë hulumtim. E para është teoria e ndryshimit (Lederach 2023), e cila është thelbësore për kohezionin social dhe ndërtimin e paqes, sepse ofron një qasje holistike për ndryshimin e lidhjeve sociale. Ajo përfshin krijimin e rrjeteve, fuqizimin e institucioneve, përfshirjen e të gjithë aktorëve/eve, iniciativave të kontekstualizuara dhe të udhëhequra nga shoqëria dhe ndërveprimin e niveleve të piramidës sociale: nivelin më të lartë të udhëheqjes politike, sociale dhe fetare, nivelin e mesëm (shoqëria civile organizatat) dhe nivelin ndër-personal.

E dyta është teoria e këndvështrimit feminist (Haraway 1986; Harding 2004) që mbështetet në tri parime kryesore: a) prodhimi i njohurive është gjithmonë i kushtëzuar dhe i vendosur nga shoqëria; b) grupet e marginalizuara janë më të vetëdijshme për marginalizimin dhe diskriminimin sesa ato të privilegjuarat; c) kritika e marrëdhënieve të pushtetit duhet të fillojë nga jeta e grupeve të marginalizuara që të jenë në gjendje t'i kuptojnë efektet shkakësore të strukturave të pushtetit. Pra, teoria e këndvështrimit feminist u jep zë atyre që janë të marginalizuara dhe relativisht të padukshëm. Në këtë hulumtim, të rinjtë/të rejtat janë grupi i synuar dhe jo vetëm që janë të marginalizuar/a nga politika dhe vendimmarrja e zakonshme, por janë edhe nën ndikimin e fuqishëm të aktorëve/eve të ndryshëm/me politikë/e dhe fetarë/e, të cilët/cilat keqpërdorin nocionin e patriotizmit për të normalizuar ndarjet artificiale etnike dhe mashkulloritetin toksik dhe hegjemonist që çojnë në dhunë dhe diskriminim me bazë gjinore. Nëpërmjet teorisë së këndvështrimit feminist dhe teorisë së ndryshimit social, ky hulumtim shqyrton pjesëmarrjen e të rinjve/të rejave në ndërtimin e paqes dhe kohezionit social, pozicionimin e tyre si anëtarë të grupeve përkatëse etnike dhe grupeve tjera në drejtim të distancës etnike, barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore, mashkulloritetit toksik dhe patriarkalitetit që prek si vajzat ashtu edhe djemtë.

1.2.2 Konsultimet rajonale online

Për të finalizuar metodologjinë e propozuar dhe metodat e hulumtimit, UN Women ka organizuar një takim nismëtar online me të rinjtë/të rejat nga pesë vendet për të mbledhur perceptimet dhe pikëpamjet e tyre lidhur me temat kryesore që u identifikuan gjatë fazës së shqyrtimit të literaturës:

1. Trashëgimitë negative të së kaluarës;
2. Narrativët nacionalist dhe antigjinore;
3. Pranimi social dhe distanca sociale;
4. Barazia gjinore për kohezionin social;
5. Pandemia e Covid-19

Në kuadrin e pikëpamjeve që pjesëmarrësit/et shkëmbyen gjatë konsultimit rajonal online, u qartësuan çështjet kryesore të studimit me fokus në temat e paraqitura më poshtë.

Pikëpamjet e mbledhura janë thjeshtësuar në pyetjet dhe nënpyetjet përkatëse hulumtuese për të analizuar nëse barazia gjinore perceptohet si thelbësore për kohezionin social nga të rinjtë/të rejat, dhe mënyrën se si mentaliteti patriarkal dhe normat e paravendosura gjinore kanë ndikuar në pabarazitë aktuale.

Pyetjet kryesore përfundimtare të hulumtimit trajtojnë nën-temat e mëposhtme:

- pjesëmarrja e grave në ndërtimin e paqes;
- ndikimi i trashëgimive negative të së kaluarës në barazinë gjinore dhe kohezionin social;
- dhuna me bazë gjinore (DhBGj) dhe ndikimi i modelit të mashkulloritetit të militarizuar, duke përfshirë ndikimin e Covid-19 në shfaqjen dhe/ose ashpërsinë e dukurive/rasteve të DhBGj, si dhe përhapjen e narrativave antigjinore;
- diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes, si në mjediset fizike ashtu edhe ato digjitale, me fokus në aktivizmin digjital;
- rekomandime nga të rinjtë/të rejat se si të adresohen sfidat e barazisë gjinore dhe kohezionit social në vendin e tyre.





Formulari i pëlqimit për fokus grupe / intervista

Faleminderit që lexuat informacionet rreth hulumtimit. Nëse dëshironi të marrni pjesë, atëherë plotësoni dhe nënshkruani formularin e mëposhtëm. Ju lutemi shënoni shtesat në kutitë e mëposhtme të kontinmuar se jeni dakord me secilin deklaratë.

Une konfirmoj se kam lexuar dhe kam kuptuar informacionet e dhëna në hulumtimin dhe kam pajtueshmëri të plotë me të gjitha kushtet e mëposhtme të parashtruara më poshtë.

Une pajtohem që pjesëmarrja ime është vullnetare dhe se jam i/e lirë të tërhiqem në çdo kohë pa pasur mundësinë të parashtruar më poshtë.

Une pajtohem që të gjithë informacionet që ofruara gjatë kësaj konsultimi do të jenë të përdorura në hulumtimin dhe se informacionet mund të publikohen në revista shkencore, artikuj gazetes dhe në media të tjera.

Une pajtohem që të gjithë informacionet që ofruara gjatë kësaj konsultimi do të jenë të përdorura në hulumtimin dhe se informacionet mund të publikohen në revista shkencore, artikuj gazetes dhe në media të tjera.

1.3 Kampioni i hulumtimit

Hulumtimi përfshin pikëpamjet e të rinjve/të rejave nga 18 deri në 30 vjeç nga pesë vendet e rajonit që mbulon projekti.

Në disa raste, të rinjtë/të rejat nën 18 vjeç u ofruan spontanisht për të marrë pjesë në aktivitetet e projektit. Konkretisht, në konsultimet vendore disa pjesëmarrës/e nën 18 vjeç kanë kërkuar të përfshihen në diskutime. Në këto raste është marrë pëlqimi i prindërve ose i kujdestarit ligjor.

Qasjet sasiore dhe cilësore të hulumtimit


SASIORE



35 pyetje të përkthyer në gjuhët vendase

U hapen nga **1232 të rinj**

810 të anketuar treguan se ku jetojnë:



CILËSORE

Konsultimet lokale



5 konsultime grupore

134 të rinj (<30)

10 pyetje u diskutuan nën drejtimin e hulumtuesve të rinj

Intervistat e thelluara




15 të rinj të lidhur me autoritetet

3 intervista për shtet/territor

6 pyetje gjithëpërfshirëse që i adresojnë çështjet kyçe të hulumtimit

1.3.1. Anketa sasiore dhe analiza e të dhënave

Shpërndarja e të anketuarve/të anketuarave në anketë



Imazhi 3. Pasqyrë demografike e të anketuarve/të anketuarave në anketë

Anketa sasiore është përgatitur nga ekipi hulumtues, me qëllim që:

- 1) Të ofrojë një dimension statistikor të opinioneve dhe perceptimeve, qëndrimeve dhe përvojave të grupit të synuar ndaj objektit të studimit;
- 2) Të identifikojë dallimet në opinione, perceptime, qëndrime dhe përvojave në kuadër të nën-objektivave të të rinjve/të rejave;
- 3) Të kuptojë lidhjet shkakësore ndërmjet opinioneve dhe sjelljeve, si dhe ndërmjet qëndrimeve dhe përvojave.

Si përfundim, grupi hulumtues ra dakord për një grup prej 35 pyetjesh. Qëllimi gjatë përzgjedhjes së pyetjeve ishte që të përfshinte çështjet kryesore të hulumtimit dhe masat përkatëse, duke ruajtur një ekuilibër me vështirësinë e detyrës dhe duke shmangur lodhjen e të anketuarve/ave (Marsden & Wright 2010). Përveç kësaj, qëllimi ishte edhe konsistenca dhe krahasimi i përgjigjeve duke u bazuar në një referencë të përbashkët në të dhënat. Megjithatë, sa herë që nevojitej, janë përfshirë referencat për kontekste specifike për t'i sqaruar dallimet në vendet dhe specifikat e konteksteve të caktuara.

Formati i pyetësorit ka ndjekur standardin e intervistimit në internet me ndihmën e kompjuter (CAWI). Pyetjet janë përkthyer në të gjitha gjuhët përkatëse vendore për të siguruar qasje maksimale për të gjitha grupet demografike të synuara. Pyetësori është kompjuterizuar dhe administruar nëpërmjet platformës digjitale të mbledhjes së të dhënave SurveyMonkey. Hulumtimi ka nisur në qershor të vitit 2023. Në këtë hulumtim është përdorur strategjia e kampionimit ortek, duke e bërë shpërndarjen me ndihmën e kontakteve të rrjetit mbështetës të projektit, duke përfshirë edhe ekipin hulumtues. Meqenëse anketa përmban të dhëna të ndjeshme për sa i përket gjinisë, vendit, nivelit arsimor dhe moshës së të anketuarve/të anketuarave, si dhe orientimit seksual, statusit të aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë fetare (për ta lehtësuar profilizimin e përgjigjeve), vëmendje e veçantë i është kushtuar mbrojtjes së të dhënave të pjesëmarrësve/eve (shih seksionin 1.4 mbi Etikën). Në fund, anketës online i janë nënshtruar 1,232 persona, nga të cilët/cilat 810 shënuan vendbanimin e tyre dhe dorëzuan anketat e plotësuara në mënyrën e duhur. Nga 810 pjesëmarrës/e, 133 shënuan vendbanimin në Shqipëri, 400 në Bosnjë dhe Hercegovinë, 84 në Kosovë, 72 në Maqedoninë e Veriut dhe 12 në Serbi.

Meqenëse ky ishte një kampion i përzgjedhur vetë, nuk ishte e mundur të përgjithësoheshin përgjigjet për popullatën e të rinjve/të rejave që jetojnë në pesë vendet, por ishte e mundur të merreshin dëshmi nga një këndvështrim specifik për pjesëmarrjen dhe interesin për çështjet e barazisë gjinore dhe kohezionit social, si dhe të verifikoheshin devijimet e perceptimeve dhe përvojave në krahasim me ato që janë zbuluar në kampionin që përfaqëson më së miri të rinjtë/të rejtat. Është realizuar një analizë e kryqëzuar duke marrë në konsideratë të dhënat e ndara sipas variablave demografike të mëposhtëm: gjinia, mosha, niveli arsimor, feja, zona (domethënë, urbane, nën-urbane, rurale).

1.3.2. Hulumtimi cilësor

Hulumtimi cilësor përfshinte konsultimet e organizuara me të rinjtë/të rejtat si dhe intervistat me përfaqësues/e të rinj/reja të institucioneve publike, puna e të cilëve/cilave fokusohet në çështjet e rinisë dhe sociale. Pjesa cilësore e hulumtimit ka ofruar një sasi të konsiderueshme të materialit për analizë më të thellë, por edhe e ka mundësuar ndërthurjen dhe validimin e rezultateve të anketës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të realizuar nga hulumtuesit/et për të përfunduar shqyrtimin e literaturës përkatëse mbi barazinë gjinore dhe kohezionin social në rajon, si dhe identifikimi me pjesëmarrje i çështjeve kyç të hulumtimit gjatë konsultimit të parë rajonal online, faza e dytë e projektit konsistonte në organizimin e pesë konsultimeve që u zhvilluan në Tiranë, Sarajevë, Beograd, Prishtinë dhe Shkup.

Konsultimet u organizuan si diskutime në grup me të paktën 20 pjesëmarrës/e, dhe u zhvilluan në gjuhët vendore, në një mjedis joformal.

Në përgjithësi, kishte disa ndryshime të vogla në metodologji duke qenë se janë marrë parasysh nevojat për zhvillimin e projektit gjatë rrjedhës së aktiviteteve. Në mënyrë të veçantë, me rastin e fillimit të projektit me prani fizike, konsultimi në Shqipëri shërbeu si një mundësi e vlefshme për të testuar metodologjinë e hulumtimit dhe për të bërë përshtatjet e nevojshme, siç është shpjeguar më poshtë.

Diskutimi në Tiranë u zhvillua me dy fokus grupe të veçanta që trajtuan çështjet kyç të hulumtimit, me dy orë për secilin fokus grup. Ndarja në fokus grupe kishte për qëllim krijimin e një hapësire të sigurt për pjesëmarrësit/et ku idetë mund të shkëmbeheshin lirshëm. Në përputhje me këtë, lehtësuesi e ka respektuar rrjedhën e natyrshme të diskutimeve spontane ndërmjet pjesëmarrësve/eve, duke prezantuar tema të gjera hulumtimi që ndërlidhen me hulumtimin duke u lënë hapësirë të rinjve/të rejave që të vendosin se në cilat çështje prioritare do të përfshiheshin.

Megjithatë u vërejt një diskutim i kufizuar për gjuhën e urrëjtjes, dhunën me bazë gjinore dhe mashkulloritetin e militarizuar, në konsultimet e tjera u ndoq një qasje më e rreptë. Në konsultimet në Sarajevë, Beograd, Prishtinë dhe Shkup, diskutimet u zhvilluan në kuadër të një shkëmbimi katër orësh me një grup më të madh të rinjsh që u angazhuan në një numër të caktuar pyetjesh. Për të siguruar që të njëjtat pyetje hulumtuese të adresohen vazhdimisht me pjesëmarrësit/et në të gjitha vendet, pjesëmarrësve/eve në Tiranë iu shpërnda një

pyetësor pasues me shkrim. Ky pyetësor integron pikat që nuk mund të trajtoheshin në fokus grupet, duke siguruar kështu krahasimin e të dhënave ndërmjet pikëpamjeve të mbledhura në Shqipëri dhe atyre të mbledhura më vonë në Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Hulumtuesit/et morën pjesë në hartimin e udhëzimeve të konsultimit me qëllim që të krijonin një numër pyetjesh specifike që do t'u mundësonin konsultimeve të paraqesin një format të standardizuar për qëllime të krahasimit të të dhënave.

Pjesëmarrësit/et u përzgjedhën në bazë të një harte gjithëpërfshirëse të aktorëve/eve që u përgatit nga ekipi hulumtues, përfshirë, por pa u kufizuar në institucionet arsimore, studentët/et e universitetit, si dhe studiues/e dhe profesorë/esha, përfaqësues/e të organizatave të shoqërisë civile dhe rrjeteve rinore, gazetarë, aktivistë, përfaqësues/përfaqësuese të organizatave rajonale, forume dhe anëtarë/e të tjerë/tjera të organizatave jofitimprurëse që janë konsideruar të rëndësishme për temat e hulumtimit (të tilla si shoqatat femine dhe OJQ-të e udhëhequra nga gratë). Kriteret e përzgjedhjes i kanë kushtuar vëmendje të duhur përfaqësimit gjeografik, gjinor dhe komunitetit, në përputhje me grupin e caktuar të synuar sipas moshës. Në këtë fazë nuk është kërkuar përkatësia politike për ta përqendruar fokusin në pikëpamjet individuale të të rinjve/të rejave për temat e hulumtimit.

Ftesat janë shpërndarë gjithandej për të përfshirë jo vetëm të rinjtë/të rejtat aktivë/e në këto tema (p.sh. anëtarët/et e organizatave të shoqërisë civile që punojnë për barazinë gjinore), por edhe ata/ato që nuk ndjekin ndonjë rrugë profesionale ose akademike që ndërlidhet me temat e projektit dhe nuk tregojnë interes specifik për t'u angazhuar në këto tema. Kjo i ka mundësuar ekipit të mbledhë informacione të ndryshme dhe të jetë dëshmojë biseda stimuluese midis pjesëmarrësve/eve me prejardhje, interesa të ndryshme, si dhe opinione dhe ide mbi temat e propozuara.

Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve/eve dhe angazhimin e tyre, vëmendje e veçantë u është kushtuar grupeve të marginalizuara dhe personave të cenueshëm. Komuniteti LGBTQIA+ ka qenë i përfaqësuar në të pesta konsultimet. Duke qenë se disa pjesëmarrës/e kanë pohuar përkatësinë e tyre ndaj komunitetit, të tjerë/të tjera preferuan që ta deklaronin atë vetëm në anketë. Personat me aftësi të kufizuara, po ashtu, kanë qenë të përfaqësuar në të gjitha konsultimet. Pakicat etnike

janë angazhuar nëpërmjet përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile që kanë lehtësuar qasjen në bazën e tyre të kontakteve dhe kanë shpërndarë ftesat tek komunitetet përkatëse. Është regjistruar në veçanti një pjesëmarrje aktive e përfaqësuesve të komunitetit rom.


U raportua se grupet kanë qenë shumë aktivë gjatë gjithë diskutimit, duke krijuar një hapësirë të sigurt për t'i shkëmbyer pikëpamjet e tyre politike dhe sociale, si dhe historitë personale. Niveli i pjesëmarrjes së regjistruar ka qenë shumë i lartë dhe pjesëmarrësit/et kanë ndërvepruar me njëri-tjetrin/njëra-tjetrën gjatë tërë diskutimit. Pjesëmarrësit/et në përgjithësi kanë qenë shumë mendje-hapur/a, të motivuar/a, entuziastë/e dhe të sinqertë/a.

Nga ana tjetër, është vërejtur se një numër i vogël i tyre kanë heziturar të flasin dhe është dashur të inkurajohen butësisht nga moderatori në mënyrë që të shfaqnin opinionet e tyre. Në disa raste, hulumtuesit/et kanë ndërhyrë për të moderuar diskutimin në mënyrë më aktive, meqenëse pjesëmarrësit/et kishin mosmarrëveshje të theksuara mes tyre. Në disa raste të rralla, pjesëmarrësit/et dukej se nuk i kuptonin qartë ose disa koncepte dhe përkufizime që ishin kyç për adresimin e çështjeve të hulumtimit. Prandaj, hulumtuesit/et i kanë njohur sërish pjesëmarrësit/et me konceptet dhe përkufizimet për t'u siguruar që të gjithë i kuptojnë ato njësoj.

Pesë konsultimet bashkuan 134 të rinj/të reja me prejardhje të ndryshme. Grupi ishte përgjithësisht i balancuar dhe përfaqësues i grupmoshave të ndryshme, identiteteve gjinore, përkatësive etnike, kontekstit të vendbanimit, prejardhjes socio-ekonomike, besimeve fetare dhe grupeve që ishin pak të përfaqësuara ose komuniteteve të cenueshme.

Një listë e palëve të interesit u identifikua dhe më pas të rinjtë/të rejat e përzgjedhur/a u kontaktuan për të zhvilluar një intervistë individuale një-orëshe online me hulumtuesin/en e ri/re në gjuhën përkatëse vendore. Personat e identifikuar janë një kampion i përfaqësimit gjeografik të të rinjve/të rejave nën 30 vjeç, që kanë lidhje ose që bashkëpunojnë ngushtë me autoritetet vendore. Pikëpamjet që ata/ato ndanë synojnë të përfaqësojnë vetëm opinionet e individëve mbi çështjet kyç të hulumtimit.

Shpërndarja e pjesëmarrësve/pjesëmarrëseve në Konsultime



Imazhi 4. Pasqyra demografike e pjesëmarrësve/pjesëmarrëseve në konsultime

Procesi i rishikimit nga bashkë-pjesëmarrësit/et i udhëhequr nga të rinjtë/të rejat nga secili prej vendeve ka ndihmuar hulumtuesit/et e rinj/reja të përmirësojnë raportet dhe punimet e tyre përkatëse.

1.4. Etika

1.1. Etika

Studimi është zhvilluar në përputhje me parimin thelbësor etik të *“mos bëni dëm”*. Ai përpiket të shmangë shkaktimin e dëmit tek individët që kontribuojnë në hulumtimin me pjesëmarrje duke siguruar pëlqimin e informuar/pjesëmarrjen vullnetare; të drejtën për t’u tërhequr në çdo kohë; mbrojtjen e të dhënave; dhe konfidencialitetin/anonimitetin.

Pjesëmarrësve/eve në hulumtim u janë ofruar informacione gjithëpërfshirëse se si të mbrohen këto parime.

Formulari i pëlqimit, që është dhënë gjatë konsultimeve vendore dhe intervistave të thelluara janë përkthyer në gjuhët vendore, dhe pjesëmarrësve/eve u është dhënë kohë e mjaftueshme për të lexuar formularin e pëlqimit dhe për ta shqyrtuar marrëveshjen me kushtet përkatëse. Pjesëmarrësit/et që kanë nënshkruar formularët e pëlqimit kanë pranuar të marrin pjesë në një anketë të shkurtër duke ofruar të dhënat e tyre demografike për qëllime statistikore. Gjithashtu, pjesëmarrësve/eve në anketën e hulumtimit u është kërkuar të japin pëlqimin e qartë për kushtet e shpërndarjes së të dhënave përpara se ta plotësojnë pyetësin. Informacionet gjithëpërfshirëse mbi kontekstin e hulumtimit, qëllimin e hulumtimit dhe shfrytëzimin e komenteve të mbledhura nga palët e interesit janë ndarë me pjesëmarrësit/et për t’u siguruar që ata/ato i kuptonin plotësisht rreziqet dhe përfitimet e mundshme të pjesëmarrjes në hulumtim përpara se ta japin pëlqimin e tyre të informuar.

Për të siguruar pjesëmarrjen vullnetare, hulumtimi njeh se pjesëmarrësit/et duhet të kenë kontrollin e plotë për sa i përket përfshirjessë tyre dhe taruajnë të drejtën për t’u tërhequr nga hulumtimi në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye. Autonomia e pjesëmarrësve/eve ishte e mbrojtur, përderisa ekipi hulumtues përpiquej t’i bënte ata/ato të ndjeheshin rehat dhe të përkrahur në ushtrimin e të drejtës

së tyre për t'u tërhequr. Vendimet e tyre lidhur me shkëmbimin e informatave janë respektuar dhe nuk është aplikuar asnjë masë shtrënguese apo ndikim i papërshtatshëm për t'i dekurajuar ata/ato që të tërhiqen. Pjesëmarrësve/eve u janë dhënë informacione të qarta dhe gjithëpërfshirëse lidhur me të drejtën e tyre për t'u tërhequr pa asnjë ndëshkim apo pasoja negative dhe atyre u është treguar procesi i qartë dhe i drejtpërdrejtë për ta ushtruar këtë të drejtë, me një pikë qendrore kontaktuese për të njoftuar me email në rast të tërheqjes.

Privatësia dhe siguria e të dhënave të pjesëmarrësve/eve janë siguruar në hulumtim duke iu ofruar pjesëmarrësve/eve ruajtjen e sigurt dhe analizën e të dhënave konfidenciale. Qasja në të dhënat e ndjeshme është e kufizuar vetëm për ekipin e hulumtimit dhe ekipin menaxhues. Ekipi hulumtues pati një qasje transparente për menaxhimin e të dhënave, duke ua komunikuar qartë pjesëmarrësve/eve masat e mbrojtjes së të dhënave, përfshirë anonimitetin dhe konfidencialitetin, praktikën e ruajtjes dhe shkatërrimit të të dhënave.

Hulumtimi respekton privatësinë e pjesëmarrësve/eve dhe ruan konfidencialitetin e të dhënave të tyre personale për të shmangur dëmin e mundshëm, siç është zbulimi i paqëllimshëm i tyre ose stigmatizimi. Pjesëmarrësit/et janë të vetëdijshëm se përmbajtja e të dhënave të tyre është anonime dhe se kontributi i tyre është konfidencial. Ata/Ato janë inkurajuar që ta shprehin lirisht mendimin e tyre në një mjedis të sigurt, të informuar qartë se përgjigjet e tyre do të përdoren për analizë duke i ndjekur standardet më të larta etike. Ata/Ato ishin të vetëdijshëm se diskutimet dhe intervistat ishin incizuar për qëllime të mbajtjes së shënimeve dhe se incizimet do të fshiheshin pas dhënies së informatave përkatëse të tyre. Pjesëmarrësit/et, po ashtu, janë informuar se kontributi i tyre do të sintetizohet në dokumentin e hulumtimit dhe se të dhënat që konsiderohen të rëndësishme për hulumtimin do të përdoren ekskluzivisht për qëllime statistikore dhe në mënyrë të përmbledhur.

1.5. Kufizimet

Në përgjithësi, qasjet me pjesëmarrje kërkojnë shqyrtim të kujdesshëm të anshmërive të mundshme të hulumtuesve/eve. Hulumtuesit/et e përfshirë/a në këtë projekt kanë bërë shumë përpjekje për të shqyrtuar anshmëritë e tyre, si dhe për të shqyrtuar mënyrën më të mirë se si t'i qasen diskutimeve në mënyrë që të krijohet një hapësirë e sigurt dhe e hapur për shkëmbimin e pikëpamjeve, si dhe të ofrohet hapësirë e barabartë që të dëgjohen të gjithë zërat. Kufizimet specifike të metodologjisë janë trajtuar më poshtë.

Kampioni. Strategjia e kampionimit ortek që është përdorur për pyetësonin e bartë rrezikun që të merren mostra jo-përfaqësuese ose të pa-balancuara. Kjo mund të shihet në praktikë për sa i përket devijimeve të madhësisë së mostrës të synuar për çdo vend me madhësinë aktuale të mostrës që është marrë, si dhe në shkallën dukshëm më të lartë të të anketuarave vajza krahasuar me të anketuarit djem. Edhe pse janë bërë përpjekje për t'i arritur grupet minoritare, mostrat përfundimtare mund të mos jenë përfaqësuese. Meqenëse konsultimet personale janë mbajtur në qendrat e mëdha urbane, kjo mund të ketë qenë pengesë për pjesëmarrjen e atyre që jetojnë jashtë këtyre zonave. Për fund, meqenëse mostrat për të gjitha aktivitetet kanë qenë vetë-përzgjedhëse, ato kanë qenë edhe të kufizuara për sa i përket asaj se sa përfaqësuese ishin për popullatën e përgjithshme të synuar.

Shqyrtimet kontekstuale. Kontekstet komplekse dhe sfiduese historike dhe kulturore që janë përfshi në fushëveprimin e hulumtimit, si dhe temat e ndjeshme që janë diskutuar, kërkojnë shumë kujdes në veprime. Përveç kësaj, mund të jetë sfiduese të sigurohet që pjesëmarrësit/et të ndjehen të sigurt/a kur flasin për çështje të caktuara ose kur japin informacione të ndjeshme. Kufizimet kohore ndoshta e kanë penguar krijimin e një hapësire diskutimi plotësisht të hapur, si dhe për t'u dhënë kohë të barabartë të gjithë/gjitha pjesëmarrësve/eve që të flasin, dhe për të mundësuar që secila temë të ketë vëmendje të mjaftueshme.



United Nations

WUN WOMEN



YOUTH

EQUAL IS MORE.





SFIDAT E BARAZISË GJINORE DHE KOHEZIONIT SOCIAL NË RAJON

2:



2. SFIDAT E BARAZISË GJINORE DHE KOHEZIONIT SOCIAL NË RAJON

Fokusi i këtij hulumtimi është që t'i eksplorojë perceptimet dhe qëndrimet e të rinjve/të rejave lidhur me barazinë gjinore dhe kohezionin social dhe të identifikojë sfidat dhe pengesat kryesore në arritjen e paqes së qëndrueshme në rajon. Çdo vend pjesë e projektit (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia) ka zhvillimin dhe sfidat e veta specifike, politike dhe kulturore, por rezultatet e hulumtimit zbulojnë shumë ngjashmëri dhe paralelizma që shihen si sfida kryesore për kohezionin social.

Rajoni karakterizohet nga efektet e tranzicionit social dhe politik që erdhi pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe rënies së regjimit të Enver Hoxhës në Shqipëri në fund të viteve 1980-ta. Konfliktet etnike të shoqëruara me ndryshime politike – tregti dhe demokratizim me një kapitalizëm neo-liberal që e zëvendësoi sistemin socialist të mirëqenies ka ndryshuar strukturën shoqërore të këtyre shoqërive dhe ka sjellë shumë sfida.

Fundi i shekullit XX u shënua nga katastrofat e mëdha njerëzore, krimet kundër njerëzimit, dhunës me bazë gjinore, shkatërrimi ekonomik dhe kulturor, varfëria, narrativa antagonistike dhe konkurruese për të kaluarën, marrëdhëniet e prishura dhe besimi. Dimensioni gjinor i këtij tranzicioni reflektohet në rritjen e mashkulloritetit hegjemonist dhe militant, ripatriarkalizimin dhe etnizimin e roleve dhe regjimeve gjinore, tërheqjen e grave në sferën private të jetës, si dhe një rënie të ndjeshme të grave në jetën publike dhe politike (Hughson-Blagojević, 2012; Spahić Šiljak, 2012; Berna, 2014; Dauti dhe Zhllima, 2016) .

Mashkulloriteti hegjonist dhe militant. Një nga sfidat e të rinjve/ të rejave, në mënyrë specifike, është trashëgimia e mashkulloritit militant që mirëmbahet nëpërmjet edukimit të caktuar formal, manifestimeve kulturore, mediave, disa narrativave fetare dhe përkujtimit të konflikteve përçarëse. Ndonjëherë fëmijët ekspozohen ndaj modeleve të heronjve të luftës dhe kriminelëve të luftës që nga mosha e re nëpërmjet arsimimit, fesë dhe familjes si mënyra që e fuqizojnë identitetin e tyre kombëtar, etnik dhe fetar (Soldo et al., 2017).

Siç shprehet Roberto Belloni: “Gjithçka, nga përhëndetjet deri tek fanellat e futbollit, përdoret për të identifikuar përkatësinë etnike dhe bindjen fetare” (2013, 284).

Ndërtimi social i roleve gjinore u cakton tiparet mashkullore dhe femërore burrave dhe grave, dhe në varësi të kontekstit kulturor dhe politik, këto veçori ndryshojnë. Megjithatë, “mashkulloriteti nuk është vetëm një konstrukt social. Ai është edhe një armë politike” (Dolan, 2011, 135), që ka qenë shumë e fuqishme dhe shkatërruese gjatë konflikteve në rajon. Modeli i idealizuar i mashkulloritit portretizohet shpesh si një burrë me uniformë – ushtar, pilot, oficer policie, etj. dhe si djalosh i ashpër me muskuj, para dhe pushtet. Kur kësaj panorame i shtohen veteranët e luftës, heronjtë apo kriminelët e luftës, mashkulloriteti mbetet i ngujuar në imazhin e burrave të dhunshëm që dinë të pushtojnë, mbrojnë, dhe ta bëjnë krenar kombin e tyre. Në këtë mënyrë, “model i burrërisë së idealizuar është i lidhur ngushtë me armët, dhunën dhe pushtetin mbi gratë” (Božanić, 2016).

Dhuna me bazë gjinore (DhBGj). DhBGj është një sfidë tjetër për të pesë vendet që i janë nënshtruar hulumtimit dhe është e lidhur ngushtë me maskulinitetin militant hegjemonist. Trupa ekzistuese e hulumtuesve/eve në rajon ka ardhur në përfundim se forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore e udhëheqin jetën e shumë grave dhe pakicave të përkatësive të ndryshme seksuale, por edhe të burrave. Hulumtimi i fundit në rajon tregon se dhuna me bazë gjinore është e përhapur në universitete dhe “është rezultat i seksizmit të brendshëm dhe pranimit të stereotipave gjinorë ekzistuese në proceset e socializimit dhe kulturë” (Spahić Šiljak et.al., 2022, f. 21.).

Hulumtimet tjera (Susmel, 2019; Popadić et al., 2019; Anketa e OSBE-së e vitit 2019; Hulumtimi Reaktor 2020; Vučenović, 2022) sugjerojnë, po ashtu, se dhuna me bazë gjinore është e përhapur në punë, në shtëpi, në marrëdhëniet e takimeve mes gjinive të ndryshme dhe në shkolla, gjë që i bën gratë, të rinjtë/të rejtat, minoritetet me përkatësi të ndryshme seksuale dhe pakicat tjera veçanërisht të cënueshme. Institucionet në të gjitha këto vende garantojnë *de jure* barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna, por *de fakto*, sistemi ligjor nuk funksionon dhe normat kulturore të fajësimit dhe turpërimit të viktimave e pengojnë shumëkënd që ta raportojë dhunën. Shoqëritë që tolerojnë dhunën me bazë gjinore dhe justifikojnë mashkulloritetin hegjemonist dhe toksik në aspektin kulturor, nuk mund të arrijnë një kohezion të qëndrueshëm social.

Përfaqësimi i ulët i grave në politikë dhe pozita vendimmarrëse. Pjesëmarrja politike e grave në rajon është zvogëluar ndjeshëm pas viteve 1990-ta dhe vetëm 2 - 4 % e grave ishin të përfaqësuara në parlamente dhe pozita vendimmarrëse (krahasuar me 24% të pozitave të garantuara pas Luftës së Dytë Botërore). Një përjashtim i këtillë nga

jeta publike kërkonte që gratë t'i rikthenin dhe t'i rifitonin të drejtat e tyre politike (Spahić Šiljak, 2012). Në dy dekadat e fundit, legjislacioni - ligjet mbi barazinë gjinore - dhe organet shtetërore për barazi gjinore janë themeluar me strategjitë e tyre për avancimin e barazisë gjinore. Megjithatë, gratë mbeten me një përfaqësim të ulët në pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ dhe ato shpesh shërbejnë si reklamë apo kukulla për një ideologji apo pushtet të caktuar politik. (Browne, 2017).

Korrupsioni, gjuha e urrejtjes, diskriminimi etnik dhe racor. Një tjetër emërues i përbashkët për pesë vendet që janë hulumtuar është korrupsioni i përhapur, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi etnik dhe racor. Hulumtimi ka konfirmuar se korrupsioni e pengon zhvillimin dhe përparimin dhe ky është një nga shkaqet kryesore të largimit të rinjve/të rejave nga rajoni.

Në shoqëritë e korruptuara është e vështirë të kultivohet besimi, solidariteti dhe të ndërtohet një sistem i mirëqenies që do të kujdesej për ata/ato që janë më pak të privilegjuar/a. Indeksi i perceptimit të korrupsionit në rajon është nën atë të 27 vendeve të BE-së (Feruni et.al., 2020), që do të thotë se ka pasoja të dëmshme në zhvillimin njerëzor, paqen e qëndrueshme dhe kohezionin social.

Të rinjtë/Të rejtat nga ky rajon konfirmojnë se diskriminimi me bazë etnike, fetare, racore, gjinore dhe përkatësi seksuale është i përhapur dhe shpesh shoqërohet me gjuhën e urrejtjes, ksenofobi, racizëm, seksizëm dhe homofobi. Pjesëtarët/et e komunitetit Rom, minoritetet etnike dhe ata/ato të përkatësive të ndryshme seksuale janë veçanërisht të prekur/a, ndërsa gratë nga këto grupe janë edhe më të prekura, pasi ato përfaqësojnë një pakicë brenda pakicës.

2.1. Perceptimet e të rinjve/të rejave për barazinë gjinore dhe kohezionin social

Gjatë diskutimeve të konsultimeve vendore në pesë vendet pjesëmarrësit/et u pyetën se si e kuptojnë gjininë dhe kohezionin social. Në vend të pyetjeve të standardizuara, hulumtuesit/et përdorën një softuer interaktiv (SLI.DO) që u mundësonte të rinjve/të rejave të vendosnin në mënyrë individuale fjalët që ata/ato besonin se ishin të lidhura ngushtë me këto dy koncepte.

Çfarë fjalësh ju vijnë në mendje kur mendoni për “kohezionin social”?



Imazhi 5. Grup fjalësh për kohezionin social¹²

Konceptet e përsëritura që të rinjtë/të rejat i kanë theksuar si të lidhura me kohezionin social tregojnë në mënyrë specifike se i është kushtuar rëndësi solidaritetit dhe barazisë, bashkëjetesës; besimit, empatisë dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, unitetit, ndërlidhjes dhe ndërveprimit, bashkëpunimit, përfshirjes dhe gjithëpërfshirjes. Në përgjithësi, këto fjalë i pasqyrojnë perceptimet e pjesëmarrësve/eve për kohezionin social si shoqëri që karakterizohet nga ndërlidhja, mbështetja kolektive, trajtimi dhe mundësitë e barabarta dhe ndjenja e bashkimit. Kjo është në përputhje me përkufizimin e dhënë më sipër të kohezionit social dhe përkufizimin e studimeve të tjera të OKB-së (UNDP, 2020) që thekson ndërveprimin, besimin, solidaritetin dhe bashkëpunimin në spektër të ndryshëm shoqëror dhe politik.

Specifikat e secilit vend të hulumtuar janë të detajuara më poshtë.

Shqipëria Pjesëmarrësit/et veçuan fjalën **angazhim** për kohezionin social që shoqërohet me grupe dhe ndërveprim social. Shoqëria shqiptare përballet me nivele të ulëta të kohezionit social, siç shpjeguan të rinjtë/të rejat gjatë konsultimit vendor. Prandaj, të rinjtë/të rejat sugjerojnë që ndërtimi i kohezionit social të bëhet nëpërmjet angazhimit social dhe vullnetarizmit.

Bosnja dhe Hercegovina. Pjesëmarrësit/et identifikuan fjalët **mirëkuptim dhe barazi** si të lidhura ngushtë me kohezionin social. Meqenëse BiH është e ndarë në vija etnike dhe rimëkëmbja e saj pas konfliktit ka sjellë një kohezionin social ndërmjet tri grupeve kryesore etnike (boshnjake, serbe, kroate) dhe të tjerë (minoritetet sipas Kushtetutës), të rinjtë/të rejat konsiderojnë se mirëkuptimi është fjala kyç që duhet të promovohet në BiH.

Kosova. Së bashku me fjalët ndërlidhje dhe solidaritet, **uniteti** është fjala që shihej si e rëndësishme për kohezionin social. Perceptimi i të rinjve/të rejave është i kushtëzuar dhe i vendosur nga shoqëria, gjë që mund të tregojë se tensionet e gjata politike në rajon mund të kenë ndikuar në perceptimet e tyre, duke bërë që uniteti të shfaqet si fjala që ngjyros strukturën shoqërore dhe politike të jetës.

Maqedonia e Veriut. Pjesëmarrësit/et u fokusuan në mbajtjen e një pikëpamjeje ndërsektoriale të koncepteve, p.sh., duke marrë parasysh kontekstin e grupeve të marginalizuara – prandaj **solidariteti** u shfaq si fjalë kyç për kohezionin social. Duke iu kundërvënë narrativave të imponuara për ndarjet etnike, të rinjtë/të rejat gjetën solidaritetin si mjet për angazhimin e tyre në ndryshime sociale.

Serbia. Dy fjalë që shpjegojnë kohezionin social janë **bashkëpunimi dhe barazia**. Meqenëse çdo kontekst social dhe politik formëson perceptimet dhe qëndrimet e qytetarëve/eve të saj, rinia në Serbi është gjithashtu produkt i mjedisit social dhe politik, i cili është i ngarkuar me mungesën e bashkëpunimit me vendet pas konflikteve të viteve 1990. Me përjashtim të Shqipërisë, të gjitha vendet e hulumtuara kanë qenë pjesë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë; pas shpërbërjes së saj, bashkëpunimi me vende të tjera u dëmtua nga konflikti i pazgjidhur në rajon.

¹² *Rrjetet sociale, Gjithëpërfshirja, Bashkëjetesa, Marrëdhëniet ndërpersonale ndërmjet grupeve sociale, Kohezioni ndërlidhet me nivelin e kënaqësisë dhe mirëqenies së anëtarëve të grupit ose shoqërisë, thelbi i përbashkët i interesit, Përfshirja sociale, Kohezioni social për mua nënkupton që e tërë shoqëria jeton dhe vepron në atë mënyrë që t'i përfshijë të gjitha grupet e shoqërisë pa dallim, Mbështetja e komunitetit, Pjesëmarrja, Etniciteti, Ulja e varfërisë, Marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, Bashkëpunimi, Kultura e përbashkët, Solidariteti, Pranimi, Ndërveprimi, Altruizmi, Simbioza, Diversiteti, Kushtet e mira, Jetesa e përbashkët, Toleranca, Progresi, Bashkimi, Reciproçiteti, Përkushtimi, Barazia gjinore, Sfidë nxënien, Një, Aktiviteti, Forca, Shokët, Interoperabiliteti, Arsyeshmëria, Shoqëria, Integrimi, Aktivizmi, Besimi, Kultura. Ndërveprimi social në komunitet, Marrëdhënia, Bashkëpunimi ndërmjet grupeve heterogjene, Shoqërimi, Respekti i ndërsjellë, Tërheqja, Ndërthurja, Lidhja, Më shumë grupe, Bashkëpunimi, Rritja, Lidhëshmëria, Proces i nxënies dhe lidhjes me të aardhmen Uniteti, bashkëpunimi, barazia, harmonia, shoqëria e fortë, Marrëdhënia. Të kuptuarit, Komuniteti, komunikimi i përbashkët, Multikulturalizmi, Harmonia, Kohezioni, Paqja, Empatia.*

Në përgjithësi, këto përgjigje tregojnë për vetëdijesimin e pjesëmarrësve/eve për konceptin e barazisë gjinore. Të rinjtë/Të rejtat e dinë se çfarë është barazia gjinore dhe çfarë duhet të jetë, prandaj ata/ato i lidhin disa nga nocionet thelbësore që lidhen me kontekstet e tyre me konceptin. Fjalët kyç më të zakonshme u referohen parimeve të drejtësisë, barazisë së mundësive dhe eliminimit të strukturave hierarkike të pushtetit.

Një analizë e ndërthurur e këtyre përgjigjeve tashmë sugjeron një lidhje midis kohezionit social dhe barazisë gjinore në këndvështrimin e të rinjve/të rejave në rajon. Konceptet e përsëritura të ofruara si përgjigje për të dyja pyetjet mund të vërehen në të vërtetë. Në mënyrë specifike:

- Gjithë-përfshirja konsiderohet thelbësisht e lidhur me kohezionin social dhe barazinë gjinore;
- Harmonia u shfaq në lidhje me kohezionin social, por edhe si harmoni gjinore në lidhje me barazinë gjinore;
- Të drejtat e njeriut – si kohezioni social ashtu edhe barazia gjinore konsiderohen të lidhura me gëzimin e të drejtave të njeriut.

Kjo ndërlidhje ndërmjet kohezionit social dhe barazisë gjinore ishte fokusi i diskutimeve të konsultimeve vendore.

¹³ Ndarja e punëve të shtëpisë, Barazia gjinore, Bashkëpunimi, Aspirimi për mirëkuptim të barazisë, Solidariteti, Mundësi të barabarta, Pozita dhe mundësi të njëjta, keqpërdorimi i termit, Gjithëpërfshirja, Barazia ndërmjet burrave dhe grave, E drejtë themelore e njeriut, Të drejta të barabarta gjinore, Fuqizim i grave, Barazia gjinore në gjuhë, të drejta të barabarta ndërmjet dy gjinive, Respekt, Qasje të barabartë në të drejta, Barazi e imagjinuar, Mundësi të barabarta, Lidhja, Drejtësi sociale, Mundësia e zgjedhjes, Përfshirja, Padrejtësi, Polarizim, Dukshmëri, Vlera njerëzore, Bashkëpunimi, Dashuri, Përfaqësim, Liri nga dhuna, Pjesëmarrje, Aborti, Protesta, Njerëzit, Normat, Mundësi të njëjta, Feminizmi modern (në kuptim negativ), e drejta e votës, pagë e barabartë, harmonia gjinore, Drejtësia, Të drejta të barabarta, jeta, politika, dallimi ndërmjet gjinive, patriarkaliteti, progresi individual, trajtimi i barabartë, kushtet dhe reagimet të drejta dhe sipas nevojave, Demokracia, Të drejtat e njeriut, tejkalimi i barrierave të traditave patriarkale, mbështetje, mos-diskriminimi, diskriminimi, dhuna me bazë gjinore.

2.2. Faktorët që mbështesin barazinë gjinore dhe kohezionin social

Në përgjithësi, diskutimet e kombinuara me analizën sasiore të të dhënave tregojnë se pjesëmarrësit/et e njohin rolin e rëndësishëm të barazisë gjinore në kontributin në kohezionin social dhe ndërtimin e shoqërive më të drejta. Megjithatë, në disa vende të rinjtë/të rejtat e shohin barazinë gjinore si një agjendë që është antiproduktive për arritjen e kohezionit social. Figura e mëposhtme përmbledh shpërndarjen e perceptimeve të të rinjve/të rejave në pyetjen se cilët faktorë ndihmojnë për një shoqëri më të fortë dhe më të drejtë.

Analiza e të dhënave të kombinuara për të gjitha vendet në rajon tregon se alternativat më të zgjedhura në mbarë rajonin ishin **qasja e barabartë në arsim cilësor dhe mundësi të barabarta për punë. Barazia gjinore** doli në vendin e tretë, e lidhur ngushtë me qasje të barabartë në kujdesin shëndetësor. Liria fetare ishte alternativa më pak e zgjedhur, ndërsa qasja e lirë në informacion ishte alternativa e dytë më pak e i zgjedhur.

Sipas mendimit tuaj, cili nga faktorët e mëposhtëm ndihmon në ndërtimin e shoqërive më të forta dhe më të drejta? Ju lutemi, zgjidhni tri më të rëndësishmet




Figura 1. Faktorët që ndihmojnë shoqëritë më të forta dhe më të drejta

Analiza për informacionin e zbërthyer rajonal tregon dallime të rëndësishme statistikore në preferencën për opsionin e barazisë gjinore kur bëhet fjalë për moshën dhe fenë: ata/ato të moshës 26-30 vjeç, veçanërisht, kishin më shumë gjasa të theksonin barazinë gjinore; Përveç kësaj, ata/ato që identifikoheshin si fetarë/e ose agnostikë/e kishin disi më pak gjasa të zgjidhnin barazinë gjinore në krahasim me ata/ato që identifikoheshin si ateistë/e ose të tjerë.

Figura 1 më sipër tregon një ndarje sipas vendit të përqindjes së pjesëmarrësve/eve që zgjedhën çdo alternativë si një nga tre zgjedhjet e tyre. Në të gjitha vendet, qasja në arsim është konsideruar po aq e rëndësishme, sa qasja në mundësi të barabarta pune. Megjithatë, ka dallime interesante kur bëhet fjalë për barazinë gjinore. Të anketuarit/rat me vendbanim në Shqipëri dhe BiH e zgjedhën këtë alternativë më pak se ata/ato që banojnë në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Në Shqipëri, përgjigja e tretë më e shpeshtë ishte liria e shprehjes, një alternativë relativisht më pak e theksuar në vendet e tjera.

Këto mospërputhje në rezultate mund të lidhen me përfundimet e nxjerra nga analiza e diskutimeve të konsultimeve vendore. Në konsultimin vendor në Shqipëri, **frika** u përmend shpesh në diskutime rreth të folurit në lidhje me çështjet përkatëse të barazisë dhe kohezionit social, veçanërisht **frika nga ndëshkimi**.

Pjesëmarrësit/et në konsultimet vendore në Shqipëri hezituan të angazhoheshin në diskutim dhe të ndanin mendimet e tyre nga frika e pasojave negative, për shkak të trashëgimisë së regjimit totalitar shqiptar (Kuçi 2023), i cili shpesh neglizhohet prej tyre. Mungesa e besimit, ndjenjës së përkatësisë dhe unitetit, që të rinjtë/të rejtat e perceptojnë, përmendet shpesh edhe në kontekstin e të folurit dhe ndërmarrjes së veprimeve për barazinë. Kjo, së bashku me analiza të mëtejshme sasiore që demonstrojnë një mungesë të konsiderueshme të besimit ndër breza, tregon një arsye të mundshme pse liria e shprehjes shihet si një hap i parë dhe gur themeli kaq i rëndësishëm për një shoqëri të drejtë në krahasim me vendet e tjera.

Përveç kësaj, diskutimet e konsultimeve vendore nxorën në dritë perceptimin e përbashkët nga pjesëmarrësit/et e rinj/reja shqiptarë/e se ndërsa vende të tjera diskutojnë për pagë të barabartë për punë të barabartë dhe përfaqësimin e grave në role drejtuese, **në Shqipëri, popullata është ende e fokusuar në çështje të tilla si e drejta për të jetuar të sigurt, pa dhunë dhe në prosperitet.** Kështu, siguria dhe prosperiteti mund të shihen si prioritete, ose si një hap i parë i domosdoshëm përpara se të merret parasysh barazia gjinore, gjë që mund të jetë gjithashtu një faktor në theksimin relativisht më të ulët të barazisë gjinore në anketën sasiore.

Rezultatet e anketës për BiH demonstrojnë një theks të madh mbi arsimin dhe mundësitë e punës, pa asnjë alternativë të veçantë të caktuar si alternativa e tretë më e përzgjedhur. Në fakt, të rinjtë/të rejat **shfaqën shqetësim** të madh në lidhje me çështjet socio-ekonomike në vend, veçanërisht vështirësinë për punësim. Megjithatë, të rinjtë/të rejat zbulojnë gjithashtu tensione që provokon barazia gjinore në shoqëritë patriarkale. Barazia gjinore ndonjëherë perceptohet si një mekanizëm përmbysës që kërcënon kohezionin social dhe kontribuon në polarizimin e mëtejshëm. Për këtë arsye nuk vlerësohet si mekanizëm unifikues.

“Barazia gjinore mund të dëmtojë kohezionin social dhe të çojë në polarizimin e mëtejshëm nga ata/ato aktorë/e socialë/e të etiketuar/a si konservatorë/e dhe ata/ato që janë më progresivë/e, kështu që në këtë kuptim, duke folur në terma afatgjatë, mund të jetë një faktor që forcon kohezionin social, por gjithashtu mund të çojë në shtresim të mëtejshëm brenda shoqërisë”.

Pjesëmarrës në konsultimin vendor, Bosnjë dhe Hercegovinë

Për më tepër, barazia gjinore u pa si përçarëse pasi pjesëmarrësit/et vunë në dukje se përmendja e temave të tilla mes njerëzve me pikëpamje të kundërta çon në armiqësi, apo edhe agresion, në vend të diskutimeve konstruktive. Kjo është një shenjë e ndjenjave antigjinore dhe reagimit që është rritur në mbarë globin. Së fundi, në përputhje me shqetësimet për një ndjenjë më të gjerë të padrejtësisë, të rinjtë/të rejat në BiH shprehën njëfarë skepticizmi ndaj programeve që synojnë të nxisin barazinë gjinore dhe kohezionin social. Ata/Ato i shohin ato si të iniciuara nga të privilegjuarit/at për të privilegjuarit/at, në vend që të arrijnë tek ata/ato që janë pjesë e grupeve të marginalizuara

dhe viktima të sistemit. Një pjesëmarrës/e solli në mënyrë specifike iniciativat e OJQ-ve përgjatë këtyre linjave duke u parë si “agjendë e komercializuar.”

Duhet të theksohet se në përgjithësi, pjesëmarrësit/et në diskutimet e konsultimeve vendore në Shqipëri, si dhe në BiH, ranë dakord se mundësitë e barabarta midis burrave dhe grave duhet të trajtohen.

Konsultimet vendore në Serbi treguan se pjesëmarrësit/et përgjithësisht ranë dakord se ekzistonte një marrëdhënie e ngushtë midis barazisë gjinore dhe demokracisë, megjithëse nuk kishte konsensus se cila është e para, ose më mirë, nëse demokracia është një parakusht dhe hapi i parë drejt barazisë gjinore apo anasjelltas. Ata/Ato mendonin se demokracia është një tipar themelor në shoqëri që duhet të forcohet për të arritur barazinë gjinore dhe kohezionin social. Ky diskutim solli edhe marrëveshjen për mungesën e vullnetit politik për të trajtuar seriozisht problemet e pabarazisë gjinore në shoqërinë serbe. Një nga problemet me të gjitha këto koncepte, siç deklaruan pjesëmarrësit/et, është se ato perceptohen nga “njerëzit e zakonshëm” si diçka e huaj, abstrakte dhe e importuar nga jashtë, gjë që është një paralele interesante me disa nga vëzhgimet e mësipërme të vërejtura në konsultimin në BiH. **Për më tepër, pjesëmarrësit/et në konsultimin në Serbi theksuan se vendi ka shumë ligje që synojnë të garantojnë barazinë gjinore, por këto ligje shpesh nuk zbatohen ose praktikohen.**

Diskutimet në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut vunë në dukje barazinë gjinore si një gur themeli për kohezionin social dhe demokracinë. Në Kosovë, pjesëmarrësit/et në përgjithësi theksuan ndikimin pozitiv të barazisë gjinore në gjithëpërfshirje, duke deklaruar se barazia më e madhe çon në integrim dhe gjithëpërfshirje brenda shoqërisë. Më konkretisht, shumica e pjesëmarrësve/eve pranuan se ndërsa është bërë përparim në vendosjen e themeleve të këtyre koncepteve, ka ende vend për zhvillim të mëtejshëm nëpërmjet aktiviteteve vetëdijesuese. Përveç kësaj, **pjesëmarrësit/et besojnë se mes të gjitha çështjeve diskriminuese me të cilat ballafaqohen në Kosovë, pabarazia gjinore dhe diskriminimi racor janë çështjet kryesore kundër kohezionit social. Ata/Ato theksuan rëndësinë e rritjes së vetëdijesimit dhe njohurive lidhur me këto koncepte që shumë banorë të Kosovës mendojnë se barazia gjinore u referohet vetëm të drejtave të grave.**

Megjithatë, në konsultimet në Kosovë, u theksua se ekziston një nevojë e madhe për të hapur diskutime për të drejtat e grave dhe feminizmin në mënyrë që të lehtësohet një avancim më i madh drejt kohezionit social në përgjithësi. U pranua nevoja për një qasje më të thellë sesa thjesht rritja e numrit të grave në parlament. U theksua se duhet t'u kushtohet vëmendje grupeve të marginalizuara brenda komunitetit LGBTQIA+, përfshirë dhe gratë nga grupe të veçanta etnike. Në përgjithësi, pjesëmarrësit/et ranë dakord për rëndësinë e madhe të barazisë gjinore në promovimin e kohezionit social.

Gjatë konsultimit në Maqedoninë e Veriut, u vu re se dallimet sociale zakonisht shihen në aspektin fetar dhe etnik, por gjinia duhet të merret parasysh sistematikisht për të arritur kohezionin social. **Pjesëmarrësit/et folën për një qasje ndërsektoriale, duke marrë parasysh faktorë si dhuna strukturore dhe normat shoqërore, dhe e panë atë si një aspekt thelbësor të përmirësimit të barazisë gjinore.** Arsyeja pse kjo është specifike është se koncepti i ndërsektorialitetit nuk është një temë e zakonshme në media ose mes aktivistëve/eve të rinj/të reja si një ide kryesore, duke treguar një përmirësim në të kuptuarit e barazisë gjinore midis të rinjve/të rejave. Veçanërisht, ndikimi i barazisë gjinore në kohezionin social u vu re në fusha të tilla si arsimi dhe qasja në burime, sidomos për grupet e marginalizuara si gratë rome.

Pjesëmarrësit/et folën për mënyrën sesi shihet diskriminimi ndaj grave rome në vendin e punës, institucionet publike dhe qasjen e tyre në mirëqenien sociale. Ata/Ato përmendën gjithashtu rëndësinë e krijimit të (komuniteteve vendore) në zonat rome. Një vajzë tregoi se në Radovish (qytet i vogël), për herë të parë, ka gra rome që mbajnë poste në autoritetet vendore, tradicionalisht të dominuara nga burrat. Ata/Ato ishin në gjendje të lidhnin rëndësinë e përfaqësimit me sjelljen dhe krijimin e politikave më të drejta për grupet e marginalizuara dhe krijimin e platformave për ndarjen e pikëpamjeve të ndryshme në nivel vendor. Siç theksoi një teoriciene feministe, Judith Lorber shumë kohë më parë (1998), ekziston një "hartë" e ndryshme sociale për burrat dhe gratë e të njëjtit grup racor që i shtresonte gratë në kufi, brenda kufirit të grupit racor ose etnik të pakicës. Megjithëse arsimi dhe pasuria lidhen me pozitat e pushtetit në jetën publike dhe politike, gratë, dhe veçanërisht gratë nga grupet minoritare, përballen me më shumë sfida se sa burrat. (Judis & Teixeira. 2002)



2.3. Marrëdhëniet ndër-grupore dhe kohezioni social

Marrëdhëniet ndërgrupore shfaqin një model interesant midis pjesëmarrësve/evetë rinj/reja në hulumtim. Megjithëse shumica e të rinjve/ të rejave jetojnë në shoqëri etnikisht të homogjenizuara, një përqindje e vogël e tyre pajtohen se është më e lehtë të jetosh në këto komunitete sesa në ato multikulturore, gjë që është një shenjë shprese se të rinjtë/ të rejat preferojnë diversitetin në krahasim me një mjedis monokulturor.

Cili nga këto pohime është i vërtetë për ju? Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë




Figura 2. Besimi ndërgrupor dhe sjellja e qasjes (I)

Në përgjithësi, në të gjitha vendet, një përqindje mjaft e lartë e të anketuarve/ave deklaruan se kishin miq nga grupe të ndryshme etnike dhe fetare. Megjithatë, në të gjitha vendet me përjashtim Shqipërinë, ka një model të qartë të rritjes së distancës sociale me rritjen e intimitetit të lidhjeve në fjalë. Ndërsa mbi 80% e të rinjve/të rejave deklaruan se kishin miq nga grupe të ndryshme etnike dhe fetare, ka një rënie të theksuar kur bëhet fjalë për pyetjen nëse ata/ato kanë pasur lidhje (mbi 50%) apo do të ishin të gatshëm/me të takoheshin me individë jashtë etnisë dhe/ose grupit të tyre fetar. Kur bëhet fjalë për martesën, ka një tjetër rënie të tillë.

Një shembull i kësaj janë rezultatet nga banorët/banoret e Bosnjës dhe Hercegovinës, ku 74% e pjesëmarrësve/eve kanë miq nga grupe të ndryshme etnike dhe fetare, por vetëm 40% kishin, ose do të konsideronin të kishin, një marrëdhënie romantike me dikë nga një etni dhe/ose grup fetar tjetër. Për më tepër, vetëm 33% do të ishin të gatshëm/me të lidhnin martesë me dikë jashtë grupit të tyre etnik dhe/ose fetar.

Martesat ndër-etnike shpesh janë të stigmatizuara dhe jo në përputhje me normat shoqërore. Arsytet pas hezitimit të të rinjve/të rejave për të pasur marrëdhënie intime jashtë grupit etnik dhe/ose fetar nuk u hulumtuan në mënyrë cilësore në këtë studim, por hulumtimi i mëparshëm cilësoi mosmiratimin e prindërve si një ndër arsytet kryesore për modelin e rritjes së distancës sociale (Turjačanin et. al.2017).

Modele të ngjashme mund të vërehen në përgjigjet në Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, shoqëria e Maqedonisë së Veriut nuk është vetëm multietnike, por edhe multikonfesionale dhe shumëgjuhëshe, dhe të dhënat më të fundit tregojnë se martesat e përziera etnikisht përbëjnë rreth 7% të të gjitha martesave (Avirovic-Bundalevska, 2021). Në këtë kuadër, rezultatet e hulumtimit japin një pamje më inkurajuese. Megjithatë, një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve/të anketuarave gjithashtu pajtohen se në përgjithësi, ata/ato vëzhgojnë njerëzit që shoqërohen më shumë me grupet e tyre etnike dhe/ose fetare.

Distanca sociale në Kosovë është e ngjashme, sipas anketës së fundit të IPS-së (Instituti për Politikat Sociale) Musine Kokalari (2023) që zbulon tensione të mëdha ndëretnike, që i atribuohen konflikteve historike, dallimeve socio-politike dhe stereotipave të përjetësuar. Edhe pse duket se ka njëfarë hapjeje për të bashkëpunuar profesionalisht përtej kufijve etnikë, të jetuarit afër është më pak i mirëpritur. Gjetjet tregojnë një distancë të konsiderueshme sociale, me 65% të shqiptarëve/eve dhe 63% të serbëve/eve që shprehin të paktën njëfarë shqetësimi me mundësinë e qëndrimit pranë njëri-tjetrit.

Siç shihet në konsultimet në Serbi dhe intervistat e thelluara, marrëdhëniet ndërgrupore janë të lidhura ngushtë me trashëgimitë negative të së kaluarës. Një nga të intervistuarit/at shpjegoi:

“Jemi ende të prekur nga konfliktet, veçanërisht brezat e vjetër. Duket se ato kanë mbetur pas, por për fat kjo po ndryshon me brezat e rinj. Unë bashkëpunoj me njerëz nga vende të tjera në rajon, por ne nuk merremi realisht me këtë. Ne po fokusohemi në gjëra të tjera.”

Pjesëmarrës në intervistë të thelluar, Serbi

I i intervistuar deklaroi se edhe pse ata janë të kënaqur me krijimin e marrëdhënieve me grupe të ndryshme etnike dhe/ose fetare, shumë nga miqtë e tyre nuk janë; ata/ato ia atribuojnë këtë të rinjve/të rejave që pranojnë në mënyrë jokritike narrativat e ofruara në familje, siç mund ta shohim nga citati i mëposhtëm:

“Shumë të rinj/të reja janë të keqinformuar dhe po pranojnë gjëra nga familja në mënyrë aspak kritike.”

Pjesëmarrëse në intervistë të thelluar, Serbi

Një model i dukshëm këtu është distanca sociale dhe lidhja e saj me trashëgimitë negative të së kaluarës, të përjetësuar, ndër të tjera, nga brezat e vjetër. Më poshtë janë rezultatet sasimore të një sërë pyetjesh në lidhje me informacionin që pjesëmarrësit/et në pyetësor ekspozohen në mjedisin e tyre familjar në lidhje me konfliktet e kaluara dhe tensionet ndëretnike.

***Cili nga këto pohime është i vërtetë për ju?
Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë.***




Figura 3. Besimi ndër-grupor dhe sjellja e qasjes (II)

Duhet theksuar se këto pyetje kanë kontekste shumë të ndryshme në çdo vend, për shkak të konteksteve specifike historike për secilin prej tyre. Për shembull, ndërsa sipas këtyre rezultateve, duket se brezat e vjetër në Shqipëri nuk diskutojnë të kaluarën, një pyetje e shtuar posaçërisht për vendet me një popullsi të konsiderueshme shqiptarësh/esh tregon se 64% e të anketuarve/ave në Shqipëri dhe 10% e atyre që banojnë në Kosovë kanë deklaruar se prindërit e tyre flasin për persekutimet dhe krimet e regjimit të Enver Hoxhës, gjë që është në përputhje me vëzhgimet nga diskutimet e konsultimeve vendore.

Në përgjithësi, çdo grup etnik flet më shumë për krimet dhe dhunën e kryer ndaj tyre dhe më pak për krimet që grupi i tyre ka kryer ndaj të tjerëve. Kultura e kujtimit dhe ballafaqimit me të kaluarën është ekskluzivisht e orientuar etnikisht dhe ka më pak vullnet për të njohur vuajtjet dhe dhimbjet e të tjerëve.

Analiza ndërsektoriale e kësaj pjese të pyetësorit tregon rëndësi statistikore sa i përket zonës së banimit (rurale kundrejt asaj urbane), moshës dhe fesë. Të anketuarit/Të anketuarat nga zonat rurale kanë më pak gjasa të kenë miq nga grupe të ndryshme etnike dhe/ose fetare dhe shumë më pak gjasa të pranojnë se do të takoheshin/kishin takuar ose do të martoheshin me dikë nga grupe të ndryshme etnike dhe/ose fetare. Kjo nuk është për t'u habitur, pasi zonat rurale priren të jenë më homogjene, ose komunitete më të vogla dhe më të izoluar.

Sa i përket fesë, nuk kishte dallime në lidhje me miqësitë ndër-etnike dhe/ose ndër-fetare; megjithatë, ata/ato që e deklaruan veten si fetarë/e kishin më pak gjasa të deklarorin se kishin dalë/do të ishin të gatshëm/ me të takoheshin ose të martoheshin me dikë nga një grup tjetër etnik dhe/ose fetar. Kjo është gjithashtu në përputhje me faktin se njerëzit fetarë priren të besojnë se martesë jashtë grupit fetar të dikujt nuk është në përputhje me atë që është caktuar nga feja e tyre. Kjo është konfirmuar edhe nga studiues të mëparshëm (Pratto et al, 2018).

Sa i përket moshës, pjesëmarrësit/et në moshë më të madhe, veçanërisht ata/ato të grupmoshës 26-30 vjeç kishin më shumë gjasa të kishin miqësi - por gjithashtu ishin më të gatshëm/me dhe/ose kishin më shumë përvojë në marrëdhëniet intime - jashtë grupit të tyre etnik/fetar. Kjo, megjithatë, mund të ndikohet nga fakti që këta pjesëmarrës/e, për shkak të moshës dhe përvojës së tyre jetësore, janë ekspozuar ndaj një grupi më të gjerë dhe më të larmishëm njerëzish dhe më shumë përvojave që krijojnë marrëdhënie intime.

Pyetjet vijuese pasqyrojnë kohezionin social në lidhje me solidaritetin dhe mbështetjen në komunitetet dhe lagjet vendore, veprimet bashkëpunuese për të diskutuar dhe gjetur zgjidhje për komunitetin dhe lirinë për të shprehur mendimin e dikujt dhe për të fituar besimin.

Shifra e mësipërme duket se paralelizon theksin në konsultimin në Shqipëri mbi një shkallë të lartë individualizmi dhe izolimi si faktorë kryesorë të mungesës së kohezionit social, pasi të anketuarit/të anketuarat me vendbanim në Shqipëri kanë më pak gjasa të pajtohen me pohimin "Në lagjen time, unë njoh njerëz që janë të gatshëm të më ndihmojnë kur të kem nevojë." Në përgjithësi, ky pohim mori një nivel mjaft të lartë pajtimi në vende të tjera. Kjo paraqet një kontrast të plotë me dy pohimet e tjera që shihen në Figurën 4 - kur bëhet fjalë

Cili nga këto pohime është i vërtetë për ju? Mund të zgjidhni më shumë se një alternativë




Figura 4. Besimi i komunitetit dhe sjellja e qasjes (III)

për bashkimin e lagjeve dhe komuniteteve për zgjidhjen e problemeve ose ndarjen e problemeve dhe përvojave të tyre personale, kjo duket të jetë një dukuri e rrallë sipas perceptimeve të të anketuarve/të anketuarave.

Kjo përputhet me pikëpamjet e shprehura gjatë konsultimeve rajonale dhe vendore se ka mungesë të hapësirave të sigurta për të rinjtë/të rejtat për t'u mbledhur dhe për të diskutuar çështjet përkatëse për ta/to, si dhe me gjetjet nga konsultimet vendore që sugjerojnë një model të vazhdueshëm të të rinjve/të rejave që shprehin nevojën që shumë njerëz të bashkohen për të sjellë ndryshime në komunitetin ose shoqërinë e tyre në përgjithësi. Ka më shumë besim të shprehur nga të anketuarit/at të njerëzit përreth tyre kur bëhet fjalë për raste individuale të nevojës për ndihmë, sesa kur bëhet fjalë për zgjidhjen e unifikuar të problemeve dhe diskutimin që mund të shkaktojë pikëpamje kundërshtuese.

Kjo është gjithashtu dëshmi se njerëzit në rajon nuk kanë një ndjenjë të zhvilluar të qytetarisë aktive dhe të përgjegjshme. Ata kryesisht mbështeten në konceptet tradicionale të *komshillëkut* (fqinjësisë) dhe mbështetjes individuale që njerëzit do të ofronin për njëri-tjetrin (Bringa 1995), por vetëdijesimi për qytetarinë aktive është shumë i ulët, gjë që është një tregues i drejtimeve për politikën e ardhshme dhe nismat për të drejtat e njeriut.

2.4. Ndikimi i trashëgimive negative të së kaluarës

Siç u përmend në seksionin e mëparshëm, trashëgimitë negative të së kaluarës janë atribuar më së shpeshti si një nga pengesat për arritjen e barazisë gjinore. Gjatë konsultimit në Shqipëri, pjesëmarrësit/et raportuan se disa pritshmëri dhe ndarja e punës midis burrave dhe grave vazhdojnë, duke ndikuar në rolet e tyre në arsim dhe në fushat profesionale. Ndikimi i roleve tradicionale gjinore u diskutua duke marrë parasysh kujtimet nga e kaluara, me shembuj të dhënë se si rolet e paracaktuara mund të kufizojnë mundësitë për burrat dhe gratë. Duke çrrënjosur tradita dhe trashëgimi nga e kaluara, u evidentua se shoqëria shqiptare po lufton kundër kësaj të shkuare, por ende ekspozon dhe respekton normat kulturore dhe patriarkale.

Trashëgimitë negative të së kaluarës janë të lidhura me kulturën patriarkale, e cila sipas pjesëmarrësve/eve ende ndikon ndjeshëm në realitetet e grave dhe burrave në Bosnjë dhe Hercegovinë. Për më tepër, pjesëmarrësit/et shprehën besimin e tyre se pritjet sociale në vendin e tyre janë formuar në përputhje me **rolet tradicionale gjinore**, perceptuar si një gur themeli i një shoqërie të shëndetshme të bazuar në vlerat familjare. Pjesëmarrësit/et ranë dakord se gratë janë në shumë raste “rojet” kryesore të patriarkatit, veçanërisht ato të gjeneratave të mëparshme. Në këtë drejtim, problemi i riprodhimit të patriarkatit nëpërmjet socializimit dhe edukimi familjar është njohur si një pengesë e rëndësishme për barazinë.

“Fatkeqësisht, duke parë nënën time dhe gjyshen time, u bë e qartë për mua se ato gjithmonë i vlerësonin burrat shumë më shumë se gratë. Një vajze i thuhet të përgatisë kafe dhe të pastrojë, ndërsa vëllait tim për shembull nuk i kanë thënë kurrë diçka të tillë. E kaluara jonë po pengon të tashmen tonë”.

Pjesëmarrëse në konsultimin vendor, Bosnjë dhe Hercegovinë

Përderisa reflektuan mbi trashëgimitë negative të së kaluarës, pjesëmarrësit/et në konsultimin në Serbi pohuan se vuajtja e grave ishte e fokusuar në rolin e grave si viktimë dhe të mbijetuara të konfliktit dhe në mënyrat specifike që ajo ndikon tek gratë, por jo tek grupet e tjera shoqërore. Disa pjesëmarrës/e thanë gjithashtu se nuk i shohin konfliktet si të përfunduara plotësisht dhe besojnë se proceset e pajtimit sapo kanë filluar, në krahasim me opinionin popullor sipas të cilit proceset e pajtimit janë drejt fundit. Kjo paraqet një tablo shumë të ndryshme sa i përket trashëgimive të së kaluarës dhe rolit që duhet të kenë gratë në të ardhmen. Në çdo rast, trashëgimitë e konflikteve shihen se janë duke ndikuar në barazinë gjinore në mënyra negative, siç tregon një pjesëmarrës/e:

“Në vitet nëntëdhjetë, ne iu drejtuam narrativës “ne” kundrejt “atyre”, ku është e rëndësishme që të jemi superiorë. Besoj se në një mjedis të tillë filloi të vinte më në pah mashkulloriteti toksik dhe u pa si një model ideal i nevojshëm për të mbrojtur atë lloj pikëpamjeje për kombin. Në këtë situatë, gratë me siguri morën pjesën më të vrazhdë dhe unë mendoj se kjo gjendje vazhdon edhe sot”.

Pjesëmarrëse në konsultimin vendor, Serbi

Gjatë diskutimit mbi trashëgimitë e së kaluarës dhe ndikimin e tyre në barazinë gjinore në shoqërinë në Kosovë, pjesëmarrësit/et theksuan aspekte të ndryshme që vazhdojnë të ndikojnë në dinamikën gjinore. Duke ndjekur modelin e parë nga diskutimet e tjera konsultative, ata/ato identifikuan normat tradicionale gjinore, të tilla si presioni shoqëror për gratë për të mbetur brenda familjes dhe privimi i arsimimit për vajzat, në lidhje me trashëgimitë e së kaluarës. Pjesëmarrësit/et theksuan normat shoqërore të rrënjosura thellë dhe besimet kulturore duke iu dhënë prioritet djemve përpara vajzave, duke përjetësuar pabarazitë gjinore dhe duke kufizuar mundësitë e grave.

Tema kryesore që u shfaq ishte prania e qëndrueshme e mentaliteteve patriarkale dhe normave tradicionale, të cilat pengojnë përparimin drejt barazisë gjinore dhe të mos njohin dhe vlerësojnë arritjet e grave. Një pjesëmarrës/e i lidhi këto qëndrime me faktorë historikë, si Revolucioni Industrial, duke krijuar mundësi të reja për burrat në fuqinë punëtore, ndërkohë që përforconte idenë e punës së papaguar të grave brenda shtëpisë si rolin e tyre kryesor. Për më tepër, gjatë diskutimit, mosvetëdija dhe mungesa e edukimit u identifikuan si faktorë që përjetësojnë pabarazitë, ku rezistenca shoqërore ndaj përmirësimit dhe emancipimit shihet se buron nga këmbëngulja dhe respektimi i normave kulturore patriarkale.

“Arsimi luan një rol jetik në nxitjen e të menduarit kritik, rritjen e vetëdijesimit për diskriminimin gjinor dhe promovimi i kurrikulave të ndjeshme gjinore mund të ndihmojë në informimin më të mirë dhe kritik të proceseve të tjera shoqërore për përfitimin e shumë njerëzve.”

Pjesëmarrës në konsultimin vendor, Shqipëri

Pjesëmarrësit/et e rinj/reja në Maqedoninë e Veriut gjithashtu eksploruan çështje të tilla si diskriminimi ndaj grave, konservatorizmi i gjeneratave, trashëgimia e politikave të barazisë gjinore nga epoka socialiste, nevoja për përfaqësim dhe përfshirje të grupeve të marginalizuara, rëndësia e thyerjes së traumave të gjeneratave dhe ndikimi i konflikteve të fundit mbi diskutimet mbi paqen.

“Është më e lehtë të flitet për të kaluarën më të largët dhe të shmangim bisedimet për konfliktet dhe historitë më të fundit si konflikti i vitit 2001 në Maqedoninë e Veriut. Mendoj se ende ndikon thellë në diskutimin e paqes në vendin tonë. Mungojnë përkthimet e disa të dhënave të rëndësishme dhe lajmet dhe informacionet feministe. Për shembull, lidhur me protestat në Kosovë pas një sulmi seksual ndaj një të miture¹⁴ kishte pak mbështetje nga feministët/et e Maqedonisë së Veriut. Ne jemi ende shumë hezitues për të folur për këto çështje që prekin shumë të tashmen”.

Pjesëmarrëse në konsultimin vendor, Maqedonia e Veriut

¹⁴ Pjesëmarrësi/Pjesëmarrësja i referohet sulmit seksual të një vajze 11-vjeçare në Kosovë të ndjekur nga protesta në Prishtinë, Tiranë dhe Shkup, të nxitura nga zhgënjimi për mungesën e perceptuar të veprimit nga ana e autoriteteve për të luftuar dhunën në baza gjinore në rajon (për më shumë informacion shih *Balkan Insight*, “Për gratë në Ballkan, hapësira digjitale është një shpatë me dy tehe”, 2023, në dispozicion në: <https://balkaninsight.com/2023/06/07/for-women-in-the-balkans-digital-space-is-a-double-edged-sword/>). Pjesëmarrësja theksoi nevojën për një mbulim më gjithëpërfshirës mediatik nga mediat që flasin maqedonisht dhe bëri thirrje për përfshirje më të madhe të feministëve maqedonase në çështjet rajonale të barazisë gjinore, duke siguruar një qasje ndërsektoriale ndaj veprimit të tyre.

Ata/Ato gjithashtu theksuan natyrën konservatore të shoqërisë në Maqedoninë e Veriut dhe se si mungesa e përkthimeve të lajmeve feministe përbën një sfidë në krijimin e kohezionit më të mirë shoqëror midis maqedonasve, shqiptarëve, romëve, boshnjakëve etj., në vend që të çojë drejt mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe solidaritetit. Ky është gjithashtu një shembull se si keqinformimi mund të luajë një rol në pengimin e barazisë gjinore, të cilin më shumë se gjysma e të anketuarve/të anketuarave të Maqedonisë së Veriut në anketën sasiore e përzgjedhën si një faktor të rëndësishëm.

Një pjesëmarrëse përmendi diskriminimin me të cilin ajo është përballur në organizatat e grave, si shqiptare dhe myslimane, dhe shumë pjesëmarrës/e ranë dakord se të rinjtë/të rejat duhet të gjejnë mekanizma më të mirë për të punuar së bashku drejt barazisë gjinore.

Në përgjithësi, është e dukshme se **mendimet që u mblodhën përmes diskutimeve në grup në të gjitha vendet tregojnë për një perceptim se trashëgimitë negative të së kaluarës janë të lidhura pazgjidhshmërisht me qëndrueshmërinë e normave tradicionale gjinore.** Konteksti historik dhe efektet e konfliktit, veçanërisht ndikimi mbi gratë dhe rolin e tyre në shoqëri, shihen si një faktor kryesor në vazhdimësinë e pabarazisë gjinore. Për shembull, ekziston një perceptim se në ish-Jugosllavi barazia gjinore ishte më e pranishme dhe bëri një hap prapa pas shpërbërjes dhe konflikteve të mëvonshme, të cilat gjithashtu ndikuan në rigjallërimin e normave patriarkale, siç treguan disa studime (Hughson-Blagojevic 2012).

Është interesante se pjesëmarrësit/et e rinj/reja theksuan gjithashtu se si kjo lidhje shkon në të dyja anët, pasi ata/ato japin shembuj se si adresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe normat konservatore patriarkale mund të çojnë në kohezion më të mirë shoqëror midis grupeve të ndryshme etnike, siç mund të shihet në fragmentin nga diskutimi në Maqedoninë e Veriut më lart.



**PENGESAT PËR
BARAZINË GJINORE DHE
KOHEZIONIN SOCIAL
NGA PERSPEKTIVA E TË
RINJVE/TË REJAVE**

3



3. PENGESAT PËR BARAZINË GJINORE DHE KOHEZIONIN SOCIAL NGA PERSPEKTIVA E TË RINJVE/TË REJAVE

3.1. Rolet e ngurta gjinore dhe pritshmëritë gjinore të stereotipizuara

Sipas mendimit tuaj, a vendosin normat kulturore dhe tradicionale pritshmëri të ndryshme ndaj burrave dhe grave në komunitetin tuaj?




Figura 5. Perceptimet e të rinjve/të rejave për pritshmëritë e ndryshme ndaj burrave dhe grave

Figura 5 tregon rezultatet nga një seksion pyetësori që pyet të anketuarit/të anketuarat nëse ata/ato mendojnë se normat kulturore dhe tradicionale vendosin pritshmëri të ndryshme për burrat dhe gratë në komunitetin e tyre. Shumica e pjesëmarrësve/eve ranë dakord se kjo ishte me të vërtetë kështu. Një pyetje e mëtejshme në anketë ofroi një listë të pritshmërive dhe pyeti të anketuarit/të anketuarat nëse këto ishin kryesisht për gratë, burrat ose të dyja gjinitë. Rezultatet tregojnë se pritshmëritë e aplikuara kryesisht ndaj grave përfshijnë:

- Të kalojnë më shumë kohë duke u kujdesur për shtëpinë
- Të mos kryejnë marrëdhënie seksuale para martesës
- Të martohen në moshë të re
- Të kenë fëmijë në moshë të re
- Të kalojnë kohë, bëjnë përpjekje dhe punë duke u kujdesur për familjen

Këto pritshmëri të aplikuara për gratë janë në përputhje me normat patriarkale që vendosin rolet kryesore të grave si kujdestare të fëmijëve që kujdesen për familjen dhe shtëpinë. Pritshmëritë më të rëndësishme ndaj meshkujve ishin:

- Të fshehin emocionet në publik
- Të jenë kryefamiljarë
- Të fitojnë më shumë se partnerja
- Të sigurojnë mbështetje financiare për familjen

Kjo është gjithashtu në përputhje me pikëpamjen e burrave si kryefamiljarë dhe mbajtësit kryesorë të familjes, dhe me normat që i shohin negativisht burrat që janë të ndjeshëm dhe shfaqin emocionet. Këto rezultate tregojnë se **pritshmëritë sociale ndaj grave dhe burrave janë formuar në përputhje me normat tradicionale me një ndarje ofruesi/ushqyesi.**

Për më tepër, rregullimi i seksualitetit mashkullor dhe femëror diktohet nga koncepti patriarkal i virgjërisë, i perceptuar tradicionalisht si një pasuri kryesore që përcakton vlerën e një gruaje. Kërkesa për virgjërinë e vajzave të familjes është e lidhur me konceptin e “nderit” (i cili shtrihet jo vetëm tek individ, por edhe te familja) dhe me nocionin e “pastërtisë” që gratë duhet të mbajnë. Ky zbulim u pa në mënyrë uniforme në të gjitha vendet.

Në konsultimet vendore u ndanë përvoja dhe perspektiva që i përforcuan këto rezultate, duke treguar se këto ide janë ende të përhapura dhe se të rinjtë/të rejtat në të gjithë rajonin janë rritur me to. Pjesëmarrësit/et në Kosovë dhe BiH vunë në dukje ndarjen e sferës private dhe publike të jetës, ku sfera private shihet si e grave, ndërsa ajo publike i përket burrave. (Hughson-Blagojevic 2012; Spahić Šiljak, 2012; Babovic & Petrovic, 2021).

Pjesëmarrësit/et në konsultime theksuan se këto vlera përjetësohen nga familjet, shpesh nga gra të tjera të moshuara në familje, dhe gjatë socializimit primar. Një pjesëmarrës/e në Serbi shprehu në mënyrë specifike mendimin se procesi i futjes së këtyre vlerave fillon në thelb që nga momenti i lindjes.

Në konsultimet dhe intervistat e thelluara në BiH, njihet riprodhimi i patriarkalizmit nëpërmjet edukimit familjar dhe socializimit si një pengesë e pranishme për barazinë gjinore. Ky riprodhim bëhet nën emrin e 'vlerave të vërteta familjare'. Të rinjtë/Të rejtat treguan shumë vetëdije se si 'rendi natyror i gjërave' i vendosur nga patriarkati kishte efekte të dëmshme në fusha të ndryshme të jetës private dhe publike. Shembujt negativë të edukimit patriarkal përfshinin dhënien e privilegjit fëmijës djal ndaj fëmijës vajzë, konceptin e punëve për "djemtë" dhe "vajzat" dhe kërkesën që fëmijët të veprojnë sipas koncepteve tradicionale të feminitetit dhe mashkulloritetit (p.sh. vajzat inkurajohen të jenë të ëmbla dhe të dobishme dhe djemtë të jenë të fortë dhe të mos tregojnë emocionet e tyre). Gjithashtu rezultoi se gratë nga brezat më të vjetër ndonjëherë perceptohen nga të rinjtë/të rejtat si mbrojtëse të vlerave patriarkale, siç ilustron citati vijues:

"Gjyshja ime habitet kur sheh që unë nuk ngrihem kur një burrë hyn në një dhomë [...] Përmes edukimit gratë inkurajohen të tregojnë emocionet e tyre - është në rregull nëse ato qajnë dhe trishtohen ose zemërohen, ndërsa burrat mësohen të ndrydhin ndjenjat e tyre, përndryshe, ato do të shiheshin si motërza dhe dështakë. Unë besoj se gratë, për fat të keq, nxisin patriarkalitetin duke rritur fëmijët meshkuj që të mos bëjnë asgjë në shtëpi, madje as për veten e tyre, ndërsa vajzat nga ana tjetër inkurajohen ta bëjnë këtë, në mënyrë që pasi të martohen, të mund të u shërbejnë burrave të tyre".

Pjesëmarrëse në konsultimin vendor, Bosnjë dhe Hercegovinë

Diskutimet e mbajtura në konsultim në Kosovë paraqesin një pasqyrë të ngjashme, me pjesëmarrësit/et që vunë në dukje normat shoqërore të rrënjësura thellë **që i japin përparësi djemve përpara vajzave**, duke përjetësuar stereotipat gjinorë dhe duke kufizuar mundësitë e grave. Të rinjtë/Të rejtat identifikuan traditat patriarkale, të tilla si pritshmëria që gratë të kujdesen për familjen, si dhe më pak mundësi dhe më pak fokus në arsimimin e vajzave, si ndikime negative. Ata/Ato gjithashtu theksuan faktin se konceptet e pastërtisë dhe moralit janë barrë që bien vetëm mbi gratë dhe vajzat - gjë që mbështet sisteme që vazhdojnë të mundësojnë dhe justifikojnë dhunën ndaj grave, fajësimin e viktimave dhe ndëshkimin e grave për shkelje të perceptuara morale.

Pjesëmarrësit/et shprehën gjithashtu shqetësime lidhur me efektet negative të pritshmërive të diktuar nga normat patriarkale për burrat. Ata/Ato vunë në dukje se pritshmëritë e ngurta të vendosura

për burrat në lidhje me mashkulloritetin mund të çojnë në ndjenja të vetëvlerësimit të ulët ose depresionit. Pritshmëria që burrat të mos shfaqin emocione mund t'i bëjë ata të hezitojnë të kërkojnë ndihmë për çështjet e shëndetit mendor.

Pjesëmarrësit/et në Maqedoninë e Veriut i perceptuan këto norma tradicionale gjinore si diçka që fillon në familje dhe në socializimin primar dhe më pas sistemohet në shkolla. Pjesëmarrësit/et në vendet e tjera gjithashtu theksuan rolin që shkolla mund të luajë në përforcimin e këtyre normave për sjelljen dhe “interesat e duhura” për djemtë dhe vajzat, si dhe përmes gjuhës seksiste dhe stereotipave të promovuar nga kujdestarët dhe tekstet shkollore. Pjesëmarrësit/et gjithashtu theksuan mungesën dhe domosdoshmërinë e edukimit seksual, si dhe mësimin e nxënësve/eve për çështje të tilla si shëndeti mendor dhe barazia gjinore.

Në konsultimin në BiH u theksua gjithashtu se ngjarjet e para të dhunës ose seksizmit me bazë gjinore ndodhin shpesh në shkollë, në moshë të hershme. Duke qenë se nuk flitet për këto gjëra, nuk ka mekanizma për mbështetje dhe sanksionim, dhe fëmijët nuk mësohen për sjelljen e duhur në këtë drejtim, apo si të identifikojnë sjelljet e papërshtatshme dhe të reagojnë ndaj saj. Kjo çon në normalizim të veprimeve të tilla. Siç tha një i/e anketuar:

“Tashmë në shkolla ndodh që vajzat, trupi i të cilave në përgjithësi zhvillohet më shpejt në krahasim me atë të djemve, bëhen objektiva të komenteve dhe prekjeve të papërshtatshme ndaj të cilave askush nuk reagon siç duhet. Edhe një gjë krejtësisht e natyrshme si menstruacionet është diçka për të cilën vajzat inkurajohen të kenë turp dhe fshehin”.

Pjesëmarrëse në konsultimin vendor, Bosnjë dhe Hercegovinë

Sa i përket Shqipërisë, të rinjtë/të rejtat sugjeruan se sistemi arsimor aktualisht përforcon stereotipat tradicionale patriarkale. Gjithashtu, sikurse në vende të tjera, ekziston një mungesë e edukimit seksual gjithëpërfshirës dhe mungesë e kurrikulave feministe në të gjitha nivelet e arsimit. Kështu, 68% e të anketuarve/ave tregojnë se institucioneve të tyre arsimore u mungon avancimi i barazisë gjinore. Për më tepër, kjo në arsim përjetëson konceptet heteronormative dhe ruan rolet tradicionale gjinore.

3.2. Dhuna me bazë gjinore

Mashkulloriteti toksik dhe i militarizuar, stereotipat e ngurtë gjinorë, gjuha e urrejtjes dhe përfaqësimi mediatik i roleve tradicionale gjinore rrisin rrezikun e dhunës, veçanërisht ndaj grave, e cila konsiderohet të jetë forma më e përhapur e dhunës në të gjithë rajonin.

Analiza e diskutimeve të konsultimeve vendore dhe përgjigjet e anketës tregojnë vetëdijësimin e përgjithshëm të të rinjve/të rejave pjesëmarrës/e për çështjen e dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, pyetjet janë formuluar me fjalët “dhunë në familje apo familjare”, në vend të “me bazë gjinore”. Arsyeja për këtë përzgjedhje të formulimit ishte se shumë nuk janë të njohur me konceptin e dhunës me bazë gjinore.

Një pyetje interaktive e bërë nga anketa ishte: “Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase dhuna në familje apo familjare ndikon negativisht në mirëqenien e të rinjve/të rejave në komunitetin tuaj?”. Përgjigjet u dhanë në formën e një rezultati nga 1 në 5, ku 1 është “aspak” dhe 5 është “shumë”. Figura më poshtë tregon rezultatet, duke treguar një konsensus të përgjithshëm se dhuna në familje ose familjare ndikon të paktën disi në mirëqenien e të rinjve. Më shumë se gjysma e të anketuarve/të anketuarave në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi janë përgjigjur se dhuna me bazë gjinore ka ndikuar shumë në mirëqenien e të rinjve. Maqedonia e Veriut pati rezultate më të përziera, me 37% që zgjodhën “shumë”. Sa u përket përgjigjeve nga BiH, nga 81% e të anketuarve/ave që u përgjigjën me 3 ose më lart, pati një shpërndarje të barabartë ndërmjet niveleve.

Analiza e ndarë sipas faktorëve demografikë tregoi se të anketuarit/të anketuarat që u identifikuan si femra kishin shumë më shumë gjasa të pajtoheshin plotësisht me këtë pohim, me mbi 53% që u përgjigjën “5” në kategorinë e femrave, kundrejt 27% në kategorinë e meshkujve. Për më tepër, kishte një rëndësi statistikore në lidhje me nivelin e arsimimit të të anketuarve/ave. Ata/ato me arsim të lartë kishin më shumë gjasa të pajtoheshin ndjeshëm me këtë pohim, në krahasim me ata/ato me arsim fillor/të mesëm/profesional. Kjo lidhet edhe me faktorët që mbështesin barazinë gjinore dhe kohezionin social (domethënë: arsimi, punësimi) të përmendur më parë në këtë kapitull.

Sipas mendimit tuaj, në çfarë mase dhuna në familje apo familjare ndikon negativisht në mirëqenien e të rinjve/të rejave në komunitetin tuaj? Ju lutemi përgjigjuni duke treguar mendimin tuaj në një nivel nga 1 në 5, ku 1 është “aspak” dhe 5 është “shumë”




Figura 6. Perceptimet e të rinjve/të rejave për dhunën në familje ose familjare

Mund të vërehen shumë paralele në perspektivat dhe shqetësimet e shprehura nga pjesëmarrësit/et e diskutimeve të konsultimeve vendore në të pesë vendet e projektit. Në mënyrë të veçantë, linjat e zakonshme përfshijnë:

- mungesën e besimit në institucionet për të zbatuar ligjet kundër dhunës në familje dhe për të mbrojtur dhe mbështetur në mënyrë adekuate viktimat;
- shqetësimet për normalizimin e dhunës nëpërmjet normave shoqërore gjinore, si dhe rrëfimet e minimizimit dhe fajësimit të viktimave në media dhe media sociale;
- ndikimi i mashkulloritetit të militarizuar dhe toksik në nivelin e dhunës ndaj grave.

Për më tepër, të gjitha këto ide paralele janë të ndërthurura, sipas këndvështrimit të pjesëmarrësve/eve, përmes një kuadri sistemik të zbatuar nga normat tradicionale patriarkale gjinore dhe të militarizuara dhe të mashkulloritetit toksik.

3.2.1 Ndikimi i mashkulloritetit të militarizuar në nivelin e dhunës ndaj grave

Glorifikimi social i luftës dhe kriminelëve të luftës mbetet një kërcënim serioz për kohezionin social në këndvështrimin e të rinjve/të rejave në rajon. Fakti që burrat që shfaqin tipare toksike të mashkulloritetit vlerësohen më shumë se ata që kontribuojnë në komunitetet e tyre me përpjekje për ndërtimin e paqes, shihet si një nga shkaqet kryesore të dhunës me bazë gjinore në vendet e hulumtuara. Natyra sistematike e mashkulloritetit toksik perceptohet se buron nga modelet e krijuara në edukim, të përforcuara nga normat shoqërore dhe të ruajtura përmes shtypjes.

Pjesëmarrësit/et në konsultimin në Serbi lidhën trashëgimitë negative të së kaluarës, mashkulloritetet toksike dhe dhunën gjinore, si dhe forma të tjera të barazisë gjinore :

“Gjatë dhe veçanërisht pas konfliktit, po krijohet një kulturë militante ku ai lloj mashkulloriteti shihet si cilësi e dëshiruar. Burri është ai që paraqitet si mbrojtës i kombit dhe mbrojtës i të gjitha të mirave”.

Pjesëmarrës në konsultimin vendor, Serbi

Gjithashtu, pjesëmarrësit/et ranë dakord se idetë mbizotëruese të rrënjosura në shoqëri në lidhje me mashkulloritetin çojnë që shumica e njerëzve të mos e njohin dhunën seksuale kur e shohin ose dëgjojnë për të. *“Të gjithë mendojnë se dhuna me bazë gjinore është kur një burrë rreh një grua”* tha një pjesëmarrës, *“por kur ai e prek atë nga mbrapa, jo të gjithë do ta konsiderojnë atë si dhunë me bazë gjinore, dhe ky është problemi”.*

Në BiH, mashkulloriteti toksik u identifikua nga disa pjesëmarrës/e në diskutime në grup si një nga shkaqet kryesore të dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore. Gjithashtu u theksua se tek vajzat e reja shpeshherë mbështetet dhe idealizohet modeli “mashkull alfa”. Siç tha një pjesëmarrëse:

“Kam shoqe (që pëlqejnë shumë djemtë dominues, edhe kur ata poshtërojnë njerëzit e tjerë ose tregojnë sjellje agresive. Ato duan të ndihen të sigurta dhe të mbrojtura, por shumë shpesh ato gra përfundojnë duke qenë viktima të atyre burrave”.

Pjesëmarrëse në konsultimin vendor, Bosnjë dhe Hercegovinë

Në Kosovë gjatë konsultimeve u përmend koncepti i mashkulloritetit toksik, me raste kur të qenit mashkull përdoret për të justifikuar sjelljet e dëmshme. Konkretisht, u diskutua rreth temës së ndarjes së hapësirave publike dhe private dhe se si kjo ka kontribuar në dhunën me bazë gjinore. U vu re se domeni publik historikisht është parë si një hapësirë që i përket burrave; domeni privat zakonisht shihet si një hapësirë për gratë.

Rrjedhimisht, është krijuar një dinamikë pushteti që nxit ndjenjën e pronësisë mbi gratë, e karakterizuar nga kontrolli mbi veprimet dhe sjelljet e grave. U vu re se kjo dinamikë, në disa raste, mund të kontribuojë në ushtrimin e dhunës ndaj grave, pasi përforcon një mentalitet që justifikon kontrollin dhe dominimin. Ky mendim ndonjëherë çon në akte agresioni pasi ato mund të shihen si një mënyrë për të përforcuar kontrollin dhe dominimin e përmendur.

Pjesëmarrësit/et në Maqedoninë e Veriut theksuan më tej natyrën sistematike të mashkulloritetit toksik dhe rrënjët e tij në edukimin, normat shoqërore dhe shtypjen. Për më tepër, një nga pjesëmarrëset në intervistat e thelluara lidhi traumat midis brezave në shoqërinë e pasluftës dhe pas konfliktit dhe dhunën me bazë gjinore:

“Si një feministe që punon drejt të kuptuarit paqësor të mënyrës sesi ne organizojmë rrugëtimin tonë, unë besoj në antimilitarizmin si një parim kyç. Konfliktet ndikojnë jo vetëm në dhimbjen fizike dhe viktimat, por edhe gjendjen psikologjike e cila shpesh anashkalohej edhe pse u sjell dëme afatgjata si individëve ashtu edhe shoqërive. Kjo ndikon në familjet, fëmijët, marrëdhëniet ndërpersonale dhe me këtë në të ardhmen e të gjithëve ne dhe mënyrën se si ne e pozicionojmë veten ndaj të tjerëve. Fatkeqësisht, trashëgimitë negative të së kaluarës ndikojnë në femicid dhe dhunën seksuale, të cilat kontribuojnë në traumën transgjenerative. Megjithatë, ajo që ne nuk kuptojmë si shoqëri është se ne kemi fuqinë për ta ndryshuar atë.”

Pjesëmarrëse në intervistë të thelluar, Maqedoni e Veriut

Pjesëmarrësit/et në konsultimin në Serbi theksuan se dhuna me bazë gjinore shpesh romantizohet nga diskurset mediatike dhe në shoqëri në përgjithësi. Ata/Ato përmendën tituj që u referohen rasteve të rënda të dhunës me bazë gjinore duke i inkuadruar ato si “telashe dashurie” ose “fund romantik tragjik” në lidhje me vrasjen. Pjesëmarrësit/et e lidhën këtë përfaqësim mediatik si të ndërthurur me pozitën e gruas në një shoqëri e cila nga ana e saj është pjesërisht e varur nga modeli i mashkulloritetit të militarizuar dhe toksik që ishte mbizotërues gjatë konflikteve. Pjesëmarrësit/et në BiH raportuan se hasën në shumë shembuj të fajësimit të viktimave në komentet e mediave sociale. Deklarata të tilla si “Ajo po e kërkonte atë” ose “Pse e gjeti veten në atë situatë në radhë të parë?” identifikohen si reagime të përhapura ndaj dhunës në mediat sociale dhe forumet publike. Shqetësimet e shprehura konfirmojnë se dhuna me bazë gjinore në rajon është e strukturuar si një diskurs mohimi dhe heshtjeje – elementi mohim/skepticizëm prodhon dhe përforcon elementin e heshtjes.



Youth 4 Inclusion, E...

Youth Cons...
Pristina, K...
03.05.20...

3.2.2 Ndikimi i pandemisë Covid-19 në shfaqjen ose ashpërsinë e rasteve të dhunës me bazë gjinore

Të anketuarit/at në konsultime iu referuan pandemisë Covid-19 si një nga faktorët që pati ndikim të rëndë te gratë dhe femijët që përjetuan më shumë dhunë në izolim në shtëpi. Të anketuarit/ at në BiH vunë në dukje se pandemia Covid-19 ndërpreu funksionimin e strehimoreve për viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke i lënë viktimat pa rrugëdalje dhe duke i detyruar ato të qëndrojnë me autorët. Mungesa e mbështetjes institucionale dhe profesionale i detyroi viktimat e dhunës me bazë gjinore të qëndrojnë në familje dhe partneritete të dhunshme. Në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, rezultatet tregojnë se rastet e dhunës në familje janë rritur gjatë pandemisë Covid-19, në Kosovë, shtatë muajt e parë të pandemisë kanë shënuar një rritje prej 11%, ndërsa periudha nga marsi 2020 deri në fund të vitit 2021 është shënuar me një rritje prej 28% të rasteve të dhunës në familje. Prevalenca e dhunës në familje ishte tashmë e lartë edhe para pandemisë dhe me Covid-19 ajo u rrit. Pjesëmarrësit/et shqyrtuan në mënyrë kritike dhe lidhën prezantimin toksik të mashkulloritetit në hulumtimin e Jordan Peterson dhe Andrew Tate¹⁵ me rritjen e dhunës dhe ndjenjave antigjinore. Të dy burrat janë figura publike me shumë ndikim që janë ithtarë të ri-patriarkalizimit dhe mashkulloritetit hegjemonist që bie ndesh me barazinë gjinore. Covid-19 gjithashtu pati një ndikim në distancën sociale dhe rritjen e individualizmit siç raportuan disa pjesëmarrës/e nga Serbia:

“Pandemia ndaloi dhe zhbëri ndryshimin e vogël pozitiv që filloi të ndodhte. Njerëzit u shkëputën më shumë nga të tjerët dhe iu drejtuan interesave të tyre personale.”

Pjesëmarrës në intervistë të thelluar, Serbi

Me gjithë pasojat negative që solli Covid-19, disa ndikime pozitive ndodhën me aktivizmin digjital femëror që filloi të lulëzonte, si lëvizja “Nisam tražila” (Nuk e kërkoja) në BiH filloi nga një grup aktoresh që paralelizuan lëvizjen #metoo. Lëvizja mobilizoi gratë për të raportuar dhunën me bazë gjinore dhe për të marrë mbështetje psiko-sociale, por edhe për të thyer “komplotin e heshtjes” që i mban gratë të burgosura në fushën e normave sociale dhe kulturore. Lëvizje të ngjashme që po ndodhnin në platforma dhe fushata të ndryshme filluan gjithashtu në Serbi, Kroaci dhe Maqedoni të Veriut si NisiSama (Ti nuk je vetëm), Meduza dhe Verujem Ti (Unë të besoj ty) ku gratë u fuqizuan të dilnin përpara, ofruan mbështetje dhe inkurajuan të kërkonin drejtësi. Hashtagët #CeraKaжувам në maqedonisht dhe #TanITregoj (#ISpeakUpNow) në shqip fituan vëmendje në Maqedoninë e Veriut. Lëvizja pati një efekt të përhapur në rajon në një formë ose në një tjetër; në Shqipëri, për shembull, u zbatuan disa fushata kundër dhunës seksuale, ndërsa Kosova kishte një fushatë digjitalë të vazhdueshme kundër përdhunimit dhe dhunës seksuale nën hashtagun #siguripervajzat.

¹⁵ Jordan Peterson është psikolog kanadez i cili është në zi për rënien e vlerave fetare dhe tradicionale familjare, duke fajësuar ideologjinë gjinore dhe agjendën LGBTQIA për tjetërsimin e të rinjve/të rejave të bardhë dhe shkatërrimin e qytetërimit perëndimor. Shihni: <https://www.theguardian.com/science/2018/feb/07/how-dangerous-is-jordan-b-peterson-the-rightwing-professor-who-hit-a-hornets-nest> (qasur më 8 gusht 2023); Andrew Tate është youtuber britaniko-amerikan dhe influencues i cili është vetëshpallur si mizogjen. Shihni: <https://www.bbc.com/news/uk-64125045>, (Qasur më 6 gusht 2023).

3.2.3 Përvojat e dhunës dhe diskriminimit

Është më e lehtë të flitet për dhunën që u ndodh të tjerëve sesa përvojat personale që përfshijnë dhunën. Shumica e njerëzve nuk janë të kënaqur me ndarjen e historive personale të dhunës, për shkak të hijes së fajësimit dhe turpërimit të viktimës, siç paraqesin shumë studime të mëparshme (Hughson-Blagojevic 2012; Spahić Šiljak, 2012; Babovic, & Petrovic, 2021). Studimi konfirmoi këtë prirje.

Në Maqedoninë e Veriut, pjesëmarrësit/et hezituan të ndajnë përvojat personale të dhunës dhe diskriminimit. Megjithatë, një i intervistuar, që është anëtar i një ministrie që punon për çështjet e barazisë gjinore, përshkroi një rast ku, pak para fillimit të një takimi, një politikan mashkull iu drejtua hapur të gjithë anëtarëve/anëtareve të kësaj ministrie dhe u tha:

“Më vjen mirë që do të kem rastin të punoj me ministrinë më të bukur, pasi të gjitha jeni gra”.

Kjo deklaratë është një nga shembujt e seksizmit dashamirës (Ćeriman dhe Spahić Šiljak 2022) që është një mënyrë e pranueshme kulturalisht e komunikimit dhe shumë shpesh gratë nuk i njohin këto forma të sofistikuar të seksizmit, sepse ato e pranojnë atë në atë masë që nuk e shohin dëmin në këto lloj deklaratash (Demukaj et.al.2019; Danaj 2020; Spahić Šiljak et.al. 2022). Në Kosovë, pjesëmarrësit/et ndanë shembuj të të dëshmuarit ose të përjetimit të sjelljeve diskriminuese dhe gjuhës së urrejtjes brenda institucioneve arsimore, veçanërisht duke synuar individët me aftësi të kufizuara ose ata nga të margjinalizuar grupe si komuniteti LGBTQIA+. Një pjesëmarrëse ndau sa vijon:

“Dua të ndaj një rast konkret. Si një grua me vështirësi në lëvizje, nuk kam pasur diskriminim në familje apo në shkollë, por në politikë kur u emërova në rolin e ambasadores. Sa herë që ecja, vëreja një ndryshim në shprehjet e tyre të fytyrës dhe biseda. U përpoqa të ndaj përvojat dhe arritjet e mia, por e vetmja gjë që kishte rëndësi për ta ishte se kisha vështirësi në lëvizje.”

Pjesëmarrëse në konsultimin vendor, Kosovë

Në BiH, të rinjtë/të rejat u përqendruan në praktikat diskriminuuese në vendin e punës. Në mënyrë të veçantë, shumë gra ndanë përvojat e tyre kur u pyetën gjatë intervistave për punë nëse ishin në një lidhje romantike dhe nëse kishin në plan të kishin fëmijë së shpejti. Pjesëmarrësit/et ndanë përvojat e tyre se përgjigjet pozitive për pyetje të tilla ulnin ndjeshëm shanset për t'u punësuar dhe se gratë nuk punësoheshin apo ngriheshin në detyrë për shkak të mendimit se ato do të ishin shumë të shpërqendruara me detyrat familjare dhe të edukimit të fëmijëve. Përvojat e mëtejshme u fokusuan në zbatimin e fragmentuar të ligjeve në lidhje me lejen e lindjes. Së fundi, disa pjesëmarrës/e ndanë përvoja të gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore - u raportua se këto incidente ndiqnin modelin e shkeljes së normave tradicionale gjinore duke u parë si një shkelje morale, duke rezultuar në një sulm personal. Një pjesëmarrëse ndau përvojën e saj kur vendosi të mos merrte mbiemrin e bashkëshortit të saj kur u martua:

“Nëna ime më tha se ishte një turp i madh, se po ofendoja burrin tim [...] Kur shkova në komunë për të caktuar datën e martesës, një burrë që punonte atje i dha vetes të drejtën të më thoshte: ‘Turp të kesh, je e vetmja grua që nuk merr mbiemrin e burrit’ Më sulmoi, një person që më shihte për herë të parë në jetë”.

Pjesëmarrëse në konsultimin vendor, Bosnjë dhe Hercegovinë

Të rinjtë/të rejat në konsultimet dhe intervistat e thelluara në Serbi e pranuan diskriminimin dhe dhunën si dukuri të shpeshta në shoqërinë e tyre, por nuk donin të diskutonin ndonjë përvojë apo ndodhi personale.



3.3 Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes

Studimi kishte për qëllim të vlerësonte edhe shkallën e diskriminimit dhe gjuhës të urrejtjes që kishin përjetuar pjesëmarrësit/et dhe mbi çfarë baze. Pyetësi përfshinte pyetje, për secilën nga kategoritë që mund të shihen në figurën më poshtë; nëse ata/ato kanë a) përjetuar personalisht b) kanë dëshmuar, c) edhe kanë përjetuar edhe kanë dëshmuar diskriminim dhe gjuhë urrejtjeje. Alternativat e tjera ishin d) jo dhe e) jo i/e sigurt. Në përgjithësi, të dhënat e grumbulluara rajonale dhe të dhënat për çdo vend të veçantë tregojnë disa statistika shqetësuese.

Kjo është ilustruar në Figurën 7 më poshtë ku janë analizuar të dhënat për komunitetet e marginalizuara ku tregohet se si një pjesë shumë më e madhe e të anketuarve/të anketuarave raportuan një formë të hasjes së diskriminimit ose gjuhë të urrejtjes në krahasim me rezultatet e përgjithshme.

A keni përjetuar ose dëshmuar personalisht ndonjë rast diskriminimi ose intolerance bazuar në arsyet e mëposhtme?

(Fokusi në komunitetet e marginalizuara)




Figura 7. Përvojat e diskriminimit në komunitetet e marginalizuara

Në përgjithësi, mbi 70% e të anketuarve/ave kanë hasur (përjetuar, dëshmuar, ose të dyja) diskriminim racor dhe/ose etnik ose gjuhën e urrejtjes. Mbi 60% kishin hasur një formë të diskriminimit të lidhur me gjininë ose gjuhën e urrejtjes. Pothuajse 60% u përgjigjën gjithashtu se kishin hasur në diskriminim ose gjuhë të urrejtjes bazuar në statusin social. Pak më pak se gjysma kishin hasur në ndonjë formë diskriminim ose gjuhën e urrejtjes drejtuar komunitetit LGBTQIA+; rreth gjysma kur bëhet fjalë për fenë. Së fundmi, në mediat sociale, diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes bazohen në mizogjini dhe diskurse homofobike. Përfaqësimi i roleve gjinore në media dhe media sociale ka një ndikim të fuqishëm në pikëpamjet e të rinjve/të rejave mbi gjininë sot pasi përjetëson stereotipa të dëmshëm gjinorë, veçanërisht në lidhje me martesën, divorcin dhe krimet me bazë gjinore. Rolet e ngurta gjinore dhe stereotipat e përfaqësuar në media kanë një efekt disproporcional të komunitetave të margjinalizuara dhe grupet e nënpërfaqësuar, të cilat janë më të rrezikuara për të qenë viktime të gjuhës së urrejtjes, përfshirë gjuhën e urrejtjes në internet.

Analiza e ndarë më tej sipas faktorëve demografikë tregon se **gratë dhe grupet minoritare priren të kenë përvojë të drejtpërdrejtë ose të kenë hasur në përgjithësi gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin** në disa ose të gjitha kategoritë e mësipërme. Më e rëndësishmja, gratë priren të ndeshen me diskriminim dhe gjuhë urrejtjeje me bazë gjinore shumë më tepër sesa burrat - dhe të anketuarit/at që e përcaktuan gjininë

e tyre si “tjetër” në masë dërrmuese u përgjigjën se kanë përjetuar gjuhën e urrejtjes dhe/ose diskriminimin me bazë gjinore, duket reguarkështudiskriminimin dhe gjuhën e urrejtjes drejtuar grave, por edhe pranisë së gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit me bazë identitetin gjinor. Vajzat gjithashtu kishin më shumë gjasa të ndeshen me diskriminim racor ose të përkatësisë etnike, si dhe statusit social. Gjuha e urrejtjes mund të shfaqet përmes kanaleve online, si gjuha e urrejtjes në internet e shfaqur përmes përdorimit të gjuhës fyese, nënçmuese ose diskriminuese në media dhe media sociale që kontribuon në përjetësimin e stereotipave të dëmshëm, duke përforcuar paragjykimet dhe perceptimet negative.

Ndikimi i medias në barazinë gjinore dhe kohezionin social perceptohet nga të rinjtë/të rejtat kryesisht si negativ, pasi mediat dhe mediat sociale shpesh shihen si një përhapës i praktikave diskriminuese gjinore dhe narrativave përçarëse.

Pjesëmarrësit/et e studimit kritikuan mediat për përjetësimin e stereotipave dhe paraqitjen e narrativave të njëanshme, veçanërisht në lidhje me martesën, divorcin dhe krimet kundër grave, dhe kërkuan raportim më të përgjegjshëm/etik për këto tema. Për më tepër, ata/ato identifikuan mediat sociale si një nga faktorët që ndikon në rritjen e individualizmit, izolimit dhe keqinformimit, që kontribuojnë më tej në përkeqësimin e problemeve të identifikuar dhe mungesën e diskutimit në lidhje me çështjet që lidhen me kohezionin social.

3.4 Përhapja e fjalimeve polarizuese të identitetit

Diskriminimi gjinor, si dhe dhuna ndaj grave dhe vajzave, nxiten të dyja nga mizogjia dhe ligjërimet homofobike, të dëmshme. Polarizimi mbizotërues i diskutimeve që pengojnë dialogun konstruktiv dhe përjetësojnë ekstremizmin shkatërrues kritikohen ashpër nga të rinjtë/të rejat në rajon, të cilët/cilat sjellin nxitjen e diskutimeve të hapura dhe të mendimit kritik dhe theksojnë nevojën për t'u larguar nga fokusi i “të fituarit” apo i “të pasurit të drejtë”.

Mashkulloriteti toksik shihet nga të rinjtë/të rejat si i përhapur përmes propagandës ‘tingëlluese logjike’ që sulmon gratë dhe promovon idenë e meshkujve alfa. Këto diskurse të dëmshme mbjellin farën që e ashtuquajtura “ideologji gjinore”¹⁶ të rritet në tokën pjellore të krijuar nga frika e origjinës tek disa burra ndaj fuqizimit të grave dhe lindin stereotipa më të ngurtë gjinorë sesa të rinjtë dhe të rejat pritët të përmbushin.

Deri në çfarë mase jeni dakord me pohimin e mëposhtëm: “Lëvizjet kundër barazisë gjinore nxisin diskriminimin dhe intolerancën ndaj grave, vajzave, personave LGBTQIA+?” Ju lutemi tregoni përgjigjen tuaj në një shkallë nga 1 në 5, ku 1 është “aspak” dhe 5




Figura 8. Perceptimet e të rinjve/të rejave për lëvizjet kundër barazisë gjinore

Figura 8 më sipër, që tregon rezultatet nga anketa sasiore, tregon disa ndjenja të përziera midis të anketuarve/ave kur lidh diskriminimin dhe intolerancën me gratë, vajzat dhe personat LGBTQIA+ me lëvizje kundër barazisë gjinore. Kjo është veçanërisht e dukshme në përgjigjet e pjesëmarrësve/eve nga Shqipëria dhe BiH.

¹⁶ Termi “ideologji gjinore” përdoret këtu për t’iu referuar një sërë besimesh, teorish ose këndvështrimesh që kritikojnë dhe kundërshtojnë atë që perceptohet si gërryerje e roleve dhe normave tradicionale gjinore. Është e rëndësishme të theksohet gjithashtu se, “në kuptimin e tij origjinal, termi, i krijuar në vitet 1970 dhe i përdorur në veprat e, ndër të tjera, të shkencëtarit politik Rule Krauss i referohet pikërisht sistemit binar të paragjyqimeve dhe asimetrisë së paracaktuar të pushtetit të bazuar në gjini që duhet të sfidohen nëse i gjithë njerëzimi dëshiron të gëzojë plotësisht të drejtat e njeriut. Në përsëritjen e tij alternative dhe

Në Serbi, të rinjtë/të rejtat që merrnin pjesë në diskutime dhe intervista e lidhën nacionalizmin dhe ideologjinë antigjinore si “të ardhur nga i njëjti vend”. Siç tha një i/e anketuar:

“Kur dëgjon politikanët të flasin për abortin, organizimin e protestave, duke thënë se gratë duhet të kenë katër fëmijë, etj., ju shihni lidhjen midis nacionalizmit dhe pabarazisë gjinore. E gjitha vjen nga i njëjti vend.”

Pjesëmarrës në intervistë të thelluar, Serbi

